



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në  
“Matematikë”  
ofruar nga  
Institucioni i Arsimit të Lartë  
Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof As. Eglantina Kalluçi

2. Prof As. Dafina Xhako

Prill/ 2024

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për programin e studimit Bachelor në “Matematikë” ofruar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Matematikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Matematikë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 4, datë 15.01.1999
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Shkresë QSHA nr. 5169/90, datë 30.12.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (2022- 2023)	12 PAE/ 5 PAK
18	Numri i studentëve: (për një cikël të plotë studimi):	23 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Komisioni shqyrtoi dokumentacionin e ngarkuar në faqen [www.ascal.al](http://www.ascal.al) (lista e dokumentacionit) për programin e studimit Bachelor Matematikë. Në datat 12.07.2023 dhe 13.07.2023 u krye vizita dy ditore në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër për t’u njohur me stafin e Departamentit të Matematikës si dhe strukturat përgjegjëse pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër e ushtron aktivitetin e tij mësimor-kërkimor bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit. Programi i studimit Bachelor në “Matematikë” i ciklit të parë ofrohet nga Departamenti i Matematikës dhe është pjesë e njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Programi i studimit Bachelor në “Matematikë” ofron përgatitjen, formimin dhe diplomimin e studentëve në fushën e matematikës dhe programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Ky program ofrohet me kohë të plotë dhe është organizuar duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018). Programi Bachelor në “Matematikë” i përket nivelit 6 (gjashtë) (bachelor) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi është organizuar në 6 (gjashtë) semestra akademike me nga 30 kredite (ECTS) secila. Programi Bachelor në “Matematikë” zhvillohet me kohë të plotë në 3 (tre) vite akademike në gjuhën shqipe. Lëndët e programit janë të ndara në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, dhe lëndë ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse sipas Udhëzimit të MASR Nr.41, dt. 24. 01. 2018. Aktualisht, Departamenti i Matematikës ka në përbërjen e tij staf akademik prej 11 (njëmbëdhjetë) pedagogësh me kohë të plotë, nga të cilët, 5(pesë) Doktor i Shkencave dhe 6 (gjashtë) Master i Shkencave.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën **Prof. As. Dr. Eglantina Kalluçi** dhe **Prof. As. Dr. Dafina Xhako** si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga koordinatorja teknike i ASCAL **Znj. Aviola Bardhi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm për herë të parë të Programit të Studimit Bachelor në “Mateamtikë” ofruar nga Departamenti Matematikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën Departamenti i Matematikës është i përgatitur dhe i angazhuar për të përmbushur standardet akademike të diplomave që lëshon. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin bazohet veprimtaria e IAL (statuti, rregullorja, strategjia etj.), dosjen e programit të studimit, dokumentacionin e sekretarisë mësimore, takimet dhe vizitat e organizuara në institucion, e cila konsistoi në njohjen me të gjitha strukturat përbërëse të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe veçanërisht me Departamentin e Matematikës, Përgjegjësen e Departamentit Prof. As. Seditë Duraj, stafin e Departamentit të Matematikës, me të cilët u diskutuan dhe u sqaruan çështje që GVJ i kishte përgatitur pas njohjes me dokumentacionin e dorëzuar dhe RVB. Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Matematikë” filloi me prezantimin e dokumentacionit të paraqitur nga IAL dhe organizimin e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standarde dhe kritere përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL. Vizita 2 ditore në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, u realizua gjatë datave 12-13.07.2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga koordinatori teknik i ASCAL, i caktuar për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësen e Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi si dhe vizitoi zyra të caktuara të këtij institucioni dhe mjediset e tij. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe çështje për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse. Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Koordinatorin Teknik i ASCAL.

Më datë 19.03.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 20/9 Prot., datë 19.03.2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 26.03.2024 IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Matematikë”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Matematikës ofron programin e studimit Bachelor Matematikë në përputhje me interesat kombëtare dhe konform kuadrit ligjor të përcaktuar në Ligjit Nr 80/2015, Neni 1, pika d, Neni 5/ 2ç. të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë. Ky fakt është pasqyruar në aktet rregullatore të IAL siç është Statuti apo Plani strategjik i zhvillimit.</p> <p>Ky program studimi është koherent me misionin e IAL të përcaktuar në Statutin e Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Plani mësimor është bashkohor dhe shterues, programet e lëndëve janë të plota e të përditësuara dhe synojnë ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kulturore kombëtare. Ky program studimi kërkon të pasurojë tregun me mësues cilësorë të matematikës, i cili ka shërbyer ndër vite si burimi kryesor për rajonin e veriut të vendit.</p> <p><b>Evidenca</b>  <b>Statuti i Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’ (05.07.2018)</b>  <b>Plani strategjik Matematikë</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit Bachelor Matematikë ofrohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e Universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Ai ka si qëllim formimin e specialistëve të lartë në fushën e matematikës, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, punën kërkimore-shkencore në matematikën teorike dhe atë të aplikuar. Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës (kryesisht me formimin e mësuesve të ardhshëm) dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë, madje i mundëson studentëve të vijojnë studimet e cikleve më të larta në IAL brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><b>Evidenca</b>  <b>Statuti i Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’ (05.07.2018)</b>  <b>Rregullore e FSHN-së.</b>  <b>Plani strategjik i Departamentit të Matematikës.</b></p>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	<p>Programi i studimit Bachelor Matematikë është hartuar në përputhje me nevojat dhe rajonale për të pregatitur mësues matematike për arsimin publik dhe atë privat të rajonit. Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor Matematikë përgatiten me njohuritë bazë të matematikës teorike dhe asaj të aplikuar duke i bërë të ndihen kompetentë në kryerjen e analizave dhe përpunimeve matematikore në fushën e ekonomisë, çështjeve sociale e më gjerë. Njohuritë e përvetësuara në tre vite akademike, janë planifikuar për tu dhënë mundësinë për të vijuar studimet e mëtejshme në të njëjtën disiplinë apo në drejtimet e teknologjisë së informacionit apo ekonomisë,</p>




	<p>megjithatë destinacioni i pjesës më të madhe të studentëve të diplomuar në këtë program është profesioni i mësuesisë.</p> <p><b>Evidenca</b>  <b>Statuti i Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’ (05.07.2018)</b>  <b>Kurrikula Bachelor Matematike 2020-2023.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër ka eksperiencë të gjatë në ofrimin e programeve të studimit në fushën e mësuesisë, që prej themelimit të tij si institut i lartë pedagogjik për përgatitjen e mësuesve për arsimin e mesëm të ulët dhe vijon ta bëjë këtë. Departamenti i Matematikës ofron programin e studimit Bachelor Matematikë dhe për këtë program janë të aktivizuar 12 personel akademik me kohë të plotë.</p> <p><b>Evidenca</b>  <b>Statuti i Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’ (05.07.2018)</b>  <b>Kurrikula Bachelor Matematike 2020-2023.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor Matematikë është hartuar në përputhje me nevojat dhe rajonale për të përgatitur mësues matematike për arsimin publik dhe atë privat të rajonit.</p> <p>Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor Matematikë përgatiten me njohuritë bazë të matematikës teorike dhe asaj të aplikuar duke i bërë të ndihën kopetentë në kryerjen e analizave dhe përpunimeve matematikore në fushën e ekonomisë, çështjeve sociale e më gjerë. Njohuritë e përvetësuara në tre vite akademike, janë planifikuar për tu dhënë mundësinë për të vijuar studimet e mëtejshme në të njëjtën disiplinë apo në drejtimet e teknologjisë së informacionit apo ekonomisë, megjithatë destinacioni i pjesës më të madhe të studentëve të diplomuar në këtë program është profesioni i mësuesisë.</p> <p><b>Evidenca Kurrikula Bachelor Matematike 2020-2023.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ gjykon se ky standard përmbushet referuar programit të ofruar, stafit të angazhuar, i cili duhet të bëjë përpjekje për të vijuar me kualifikimet shkencore. Ky institucion është i vetmi në pjesën veriore të Shqipërisë dhe luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin arsimor dhe kulturor të rajonit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Statutin e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, GVJ evidenton se ekzistojnë të gjitha strukturat brenda institucionit qofshin këto akademike, ndihmë-akademike dhe administrative referuar përcaktimeve në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe të reflektuatuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Luigj Gurakuqi”.</p> <p>Universiteti “Luigj Gurakuqi” është i përbërë nga gjashtë fakultete dhe Departamenti i Matematikës është njësi bazë në përbërje të Fakultetit të</p>

përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Shkencave të Natyrës. Nga vizita e kryer me strukturat respektive administrative dhe akademike vihet re funksionimi i tyre konform përcaktimeve ligjore dhe me qëllim mbarëvajtjen e procesit mësimor, shkencor dhe administrativ.</p> <p><b>Evidenca: Organika e USH</b>  <a href="https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese">https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese</a></p>			
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	<p>Referuar publikimeve në faqen zyrtare si dhe nga takimi që GVJ realizoi me përfaqësues të Zyrës së Marrëdhënieve më Jashtë rezultoi se institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj. Aktualisht Universitetit “Luigj Gurakuqi” ka marrëveshje aktive me dhjetëra universitete evropiane, ku dominojnë ato me Italianë.</p> <p>Evidence për thirrjet e hapura si dhe projektet aktive është informacioni i publikuar në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://unishk.edu.al/bashkepunimi-nderkombetar/erasmus">https://unishk.edu.al/bashkepunimi-nderkombetar/erasmus</a>  <a href="https://unishk.edu.al/bashkepunimi-nderkombetar/bashkepunime">https://unishk.edu.al/bashkepunimi-nderkombetar/bashkepunime</a></p>			
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	<p><i>Nga vizita dhe takimi me strukturat përgjegjëse GVJ evidentoi se universiteti ka pak praktika për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës për një sërë programesh studimi, kryesisht në ciklin e dytë.</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri GVJ vë re se ekzistojnë evidenca në Raportin e veprimtarisë vjetore Mësimore –Shkencore 2021-2022, në Univesitetin e Shkodrës, në të cilën pasqyrohet edhe analiza e Departamentit të Matematikës si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor Matematikë, për raportet analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, të cilat konsistojnë në vlerësimin e mobiliteteve të stafit dhe pedagogëve dalës dhe hyrës, në komunikimin e eksperiencës së fituar tek anëtarët e tjerë të personelit akademik.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Në rastin e programi të studimit Bachelor Matematikë nuk ka evidenca për marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara, fakt që justifikohet pasi në planin mësimor të këtij programi nuk kryhet praktikë profesionale. GVJ e konsideroi këtë kriter një pikë të fortë të njësisë pasi shkëmbimet kanë qenë të shpeshta në të dy kahet.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Referuar dokumentacionit shkresor të vënë në dispozicion GVJ arrin në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Matematikë është i organizuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, si dhe VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”.</p> <p>Bazuar në Planim mësimor të programit Bachelor Matematikë dhe në takimet me përgjegjësen dhe stafin e departamentit u vu re se ky program studimi është i organizuar në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor realizohet në 3 (tre) vite studimi (6-gjashtë, semestra), me një numër total kreditesh 180. Lëndët mësimore janë të klasifikuara sipas kategorive A, B, C, D, E, sipas këtyre përqindjeve:</p> <p>A. Lëndë bazë (30 kredite – 16.7%);            B. Lëndë karakterizuese (92 kredite – 51.11%);            C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese (22 kredite – 12.2%);            D. Lëndë Plotësuese (27 kredite – 15%);            E. Detyrime Përmbyllëse (7 kredite – 3.8%).</p> <p>Kurrikula është e ndërtuar në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga kuadri ligjor si dhe programet e ngjashme brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë</b>  <b>Rregullore e Programeve të studimit Bachelor Matematikës.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga Departamenti i Matematikës (<b>Plani mësimor dhe syllbuset e lëndëve</b>) GVJ vuri re se programi i studimit Bachelor Matematikë përmban lëndë bazë të matematikës që i ndihmojnë në formimin e mirë nëse do të ndjekin drejtimin e mësuesisë, si dhe në lëndë specifike për t’ju dhënë mundësinë e një baze të përshtashtme për ato që do të ndjekin rrugën e kërkimit shkencor. Në kurrikulen e programit të studimit vihen re lëndë nga disipinat Informatike dhe Fizike si dhe lëndë plotësuese si Gjuhë e huaj (në dy semestra).</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë.</b>  <b>Syllbuset e lëndëve të programit Bachelor Matematikë.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas</p>	<p>Referuar VKM Nr. 41 datë 24.01.2018, pika 2, shtojca nr.1, programi i studimit Bachelor Matematikë është organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi përmban 23 lëndë (180 kredite ECTS), dhe përgatitjen e diplomës (tezë/</p>






kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	provim formimi me 6 kredite) pra në total 180 kredite të shpërndara në tre vite akademike. <b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e programit Bachelor Matematikë.</b>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.	<i>Në programin e studimit Bachelor Matematikë nuk ka të planifikuar praktikën profesionale, ndërkohë që detyrimet përmblylëse zënë 3.89% të ngarkesës totale të programit të studimit.</i> <b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e programit Bachelor Matematikë.</b>
<b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nga GVJ u konstatua se programi i studimit Bachelor Matematikë është i strukturuar konform të gjithë elementeve të përcaktuar nga Ligji i Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Plani mësimor është i përbërë nga 6 semestra të ndarë në 3 vite akademike, ku lëndët janë të ndara sipas tipit të veprimtarisë. Syllabuset i përmbajnë të gjithë elementet e kërkuara në VKM 41, datë 24.01.2018. <b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e programit Bachelor Matematikë.</b> <b>VKM 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”.</b>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Referuar planit mësimor të programit Bachelor Matematikë të ofruar nga Universiteti i Shkodrës dhe programeve të ngjashme në universitete të tjera rezulton se ato janë të ngjashme në masën 70%. <b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e programit Bachelor Matematikë, Universiteti ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër.</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë, Fakteti i Shkencave të Natyrës. Universiteti i Tiranës.</b>
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në dokumentacionin e dorëzuar gjendet kodi i programit të studimit dhe konkretisht ai është 63BA0541S. Referuar syllabuseve të lëndëve rezulton se ato janë të shoqëruara me kodet. <b>Evidenca: Shkresa për kodifikim.</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e programit Bachelor Matematikë.</b>
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program studimi nuk është i përbashkët me ndonjë IAL tjetër vendase apo të huaj.
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se kurrikula e programit Bachelor Matematikë është në përputhje me kuadrin ligjor dhe normativat që lidhen me të. Dokumentacioni i vënë në dispozicion është i plotë dhe përmbush kriteret e përcaktuara në Kodin e Sigurimit të Cilësisë dhe aktet nënligjore.</i>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion programi i studimit Bachelor Matematikës është hapur në vitin akademik 1999, me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr.4, datë 15.01.1999. Plani mësimor i këtij programi i është nënshtruar vlerësimit periodik nga Senati Akademik i USH dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Nuk disponohen dokumentacione të tjera që evidentojnë riorganizimin e programit të studimit nga 4 (katër) vite akademike në 3 (tre) vite akademike. Njësia kryesore është FSHN, e cila përbëhet nga 5 njësi bazë dhe Departamenti i Matematikës me përbërje 12 PAE/ 5 PAK është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit Bachelor Matematikë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr.4, datë 15.01.1999.</b>  <b>Statuti i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (2018).</b>  <b>Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës.</b>  <b>Rregullore e programeve të studimit të Departamentit të Matematikës.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Referuar Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës, Neni 6, GVJ vë re se ky është një kriter i përmbushur si nga njësia kryesore ashtu edhe nga ajo bazë.</p> <p>Sa i takon realizimit të praktikave mësimore në kurrikulën e këtij programi studimi nuk ka të planifikuar praktikë profesionale.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës.</b>  <b>Vendimi: Emërimi i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Referuar Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës, GVJ vë re se ky është një kriter i përmbushur si nga njësia kryesore ashtu edhe nga ajo bazë. Koordinator i programit të studimit është përgjegjësi i njësisë bazë, momentalisht është Prof. As. Sidië Duraj. Detyra dhe përgjegjësia e koordinatorit është të kontrollojë ecurinë e procesit mësimor të studentëve dhe ti përcjellë drejtuesit të njësisë kryesore nevojat e tyre. Nga komunikimi me Prof. As. S. Duraj evidentohet se ekziston bashkëpunimi midis instancave të ndryshme dhe mbështetja e kërkesave dhe nevojave që vijnë nga njësia bazë, në funksion të mirëkoordinimit dhe mbështetjes.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës.</b>  <b>Vendimi: Emërimi i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët.</b></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 10

<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se mungojnë dokumentacione dhe evidenca për ndryshimet që ka pësuar ky program studimi nga akti i hapjes deri në vitin aktual. Pavarësisht historikut të munguar të ristrukturimeve, programi aktual është në përputhje me aktet ligjore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ nga dokumentacioni që ka shqyrtuar si dhe nga takimi i zhvilluar me përfaqësues të njësisë kryesore dhe ato të njësisë bazë arrin në përfundimin që ato disponojnë dokumentacionin e plotë për programin e studimit ku përfshihen: Rregullorja e programeve të studimit të Departamentit të Matematikës; Planet mësimore (2020-2023 dhe 2021-2024) të shoqëruar me Syllabuset e lëndëve përkatëse dhe suplementin e diplomës, të gjitha sa më lart referuar LAL Nr 80/2015, Neni 25, pika 4 dhe VKM VKM Nr. 41 datë 24.01.2018. <b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve.</b> <b>Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë.</b> <b>Forma e diplomës Bachelor Matematikë.</b>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor/ jashtë auditorit.	Referuar Planit mësimor të programit Bachelor Matematikë dhe formës së suplementit të diplomës, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor Matematikë është i hartuar konform përcaktimeve të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”, të kategorizuara si më poshtë: A. Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme (32 kredite – 17.8%). B. Lëndë të formimit karakterizues: përgatitje për disiplinën shkencore: (92 kredite – 51.11%). C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese: Lëndë të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me lëndët karakterizuese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: (22 kredite – 12.22%). D. Lëndë Plotësuese: Lëndë formuese dhe aktivitete që lidhen me përfundimin e aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikës, praktikë: (27 kredite – 15%). E. Detyrime Përmblyëse: Teza e diplomës ose provimi i formimit: (7 kredite – 3.89%). <b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve.</b> <b>Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë.</b> <b>Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</b>

<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe informacioni në faqen zyrtare të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet dhe se njësia kryesore dhe njësia bazë përdorin një mekanizëm transparent për pranimit, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, Udhëzim i MASR, Nr.10, datë 15.05.2019 dhe udhëzimet e përvitshme për afatet kohore dhe listën e dokumentacioneve.</p> <p><i>Mungon shpallja e kriterëve për pranimet në ciklin e parë në faqen e fakultetit, pavarësisht vaktit se maturantët i referohen web site të RASH-it.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Bazuar në Planin mësimor, syllabuset e lëndëve si dhe diskutimin online me përfaqësuesit e Departamentit të Matematikës, GVJ arriti në përfundimin se plani mësimor përmban informacion të plotë mbi kurrikulën e programit Bachelor Matematikë. Përcaktimi i krediteve për secilën lëndë është në proporcion me standartin 25 orë mësimore punë për kredit. Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas përcaktimeve në VKM 41 datë 24.01.2018, dhe kanë të gjithë elementet që përcaktojnë ndarjen e ngarkesës për secilën lëndë në auditor dhe jashtë tij, si dhe mënyrën e vlerësimit (Provim ose Vlerësim i vazhdueshëm) dhe kontrollin e dijeve.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve.</b>  <b>Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë.</b>  <b>Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga konstatimet e planit mësimor të programit të studimit Bachelor Matematikë, GVJ vë re se ai është pothuajse i pandryshuar, por Departamenti i Matematikës përpiket në mënyrë të vazhdueshme të përmirësuar programin e studimit duke përditësuar literaturën dhe përmirësuar metodologjinë e përcimit të dijeve.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve.</b>  <a href="https://unishk.edu.al/studimi-nc-unishk/cikli-i-pare-bachelor/viti-akademik-2023-2024">https://unishk.edu.al/studimi-nc-unishk/cikli-i-pare-bachelor/viti-akademik-2023-2024</a></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Mungon shpallja e kriterëve për pranimet në ciklin e parë në faqen e fakultetit, pavarësisht vaktit se maturantët i referohen web site të RASH-it. Gjithashtu vihet re që programi i studimit nuk ka pësuar ndryshime, gjë të cilën drejtuesit duhet ta kenë parasysh me qëllim që studentët të kenë më shumë mundësi për vijimin e studimeve të ciklit të dytë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar Planit Mësimor, Syllabuseve të lëndëve dhe Supplementit të Diplomës Bachelor në Matematikë rezulton se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve janë hartuar me qëllim që tu mundësojnë studentëve formim të plotë në fushën e matematikës edhe punësimin në një shkallë të gjerë pasi të kenë përfunduar programet master i shkencave ose master profesional.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve.</b>  <a href="https://unishk.edu.al/studimi-nc-unishk/cikli-i-pare-bachelor/viti-akademik-2023-2024">https://unishk.edu.al/studimi-nc-unishk/cikli-i-pare-bachelor/viti-akademik-2023-2024</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Referuar Planit mësimor të programit Bachelor Matematikë, GVJ evidenton se ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, për çdo lëndë është e përcaktuar saktë në bazë të krediteve që ka secila tyre. Në këtë program studimi të gjitha lëndët kanë raportin 2:3, 2:2 ose 1:2 (3 orë leksione në javë në auditor dhe 2 orë seminare/ushtrime/laboratore).</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve.</b>  <a href="https://unishk.edu.al/studimi-nc-unishk/cikli-i-pare-bachelor/viti-akademik-2023-2024">https://unishk.edu.al/studimi-nc-unishk/cikli-i-pare-bachelor/viti-akademik-2023-2024</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Matematikës, si Planin Mësimor dhe Supplementi i diplomës i programit të studimit Bachelor Matematikë si dhe diskutimin me anëtarët e departamentit konstatohet se ky program studimi është i strukturuar në mënyrë të ngjashme jo vetëm me programet e të njëjtit profil brenda vendit por edhe me programe të ngjashme ndërkombëtare, në përputhje me sistemin Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Ngarkesa semestrare është e ekuilibruar përsa i përket shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesa totale vjetore është 60 kredite dhe lëndët variojnë me kredite nga 3 në 8.</p> <p><b>Evidenca: Supplementi i diplomës Bachelor Matematikë.</b>  <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2022-2025.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në gjetjet e GVJ në listën e dokumentacioneve si dhe nga takimi me stafin akademik dhe administrativ të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, u arrit në përfundimit se programi i studimit Bachelor Matematikë është ndarë sipas veprimtarive formuese në masën: lëndët bazë 32 kredite, lëndët karakterizuese 92 kredite, lëndët ndërdisiplinore dhe integruese 22 kredite, lëndët plotësuese 27 kredite dhe detyrime përmbyllëse 7 kredite. Kjo ndarje është e drejtë pasi tregon predispozitën institucionale për të favorizuar dhe nxitur transferimin e krediteve nga një program studimi jo detyrimisht i profilit Matematikë, pasi lëndët bazë përbëjnë 32 kredite dhe numri minimal i krediteve për kryerjen e transferimit është 30 kredite.</p> <p><i>Studentët e ciklit të parë në Matematikë kanë qenë të përfshirë në programin "Erasmus +", por nuk vihet re trend për ardhje studentësh me anë të transferimit të studimeve apo për punësim pas përfundimit të studimeve.</i></p> <p><b>Evidenca: Supplementi i diplomës Bachelor Matematikë.</b></p>

	<b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2022-2025.</b>
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se modeli i përdorur për hartimin e syllabuseve, në programin e studimit Bachelor Matematikë përmban të gjithë elementet sipas përcaktimeve VKM nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2.8. Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literaturë ndihmëse. Vlerësohet si disavantazh mospunësimi me një diplomë Bachelor në Matematikë, kjo evidente edhe për programe studimi të ngjashme brenda vendit. Vihet re një përpjekje e stafit akademik të departamentit për përdorimin e literaturës bashkëkohore megjithatë ka vend për përmirësim. <b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2022-2025.</b>
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ vlerëson përmbushjen e këtij kriteri dhe gjykon se përmbajtja e programit të studimit garanton dhe është në përputhje të plotë me përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e çdo lënde në këtë program. <i>Disiplinat matematikore zhvillohen vetëm leksione dhe seminare me përjashtim të lëndës Analizë Numerike dhe sugjeron që të shtohen edhe orë laboratorike, sidomos në lëndët Probabilitet-Statistikë të cilat mundësohen nëpërmjet softeve kompjuterike.</i> <b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2022-2025. Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë.</b>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Referuar Planit mësimor dhe përcaktimeve në Suplementin e diplomës për programin e studimit Bachelor Matematikë, GVJ gjykon se përmbajtja e programit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin Master Profesional ose Master i Shkencave në Universitetin e Shkodrës ose në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Destinacioni më i mundshëm i studentëve të diplomuar në Bachelor Matematikë është mësuesia dhe vlen të përmendet fakti që tashmë “Mësuesia” është profesion i rregulluar dhe përveç përfundimit të programit master nevojitet edhe licensimi. <b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2022-2025. Suplementi i diplomës Bachelor Matematikë.</b>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ sugjeron që nevojitet një strategji specifike për tërheqjen e studentëve si dhe një studim i tregut të punës me qëllim propozimin e mekanizmave që do të rrisnin numrin e studentëve në ciklin e parë dhe interesin e tyre për të vijuar përsëri studimet e ciklit të dytë në po të njëjtin universitet. Vlerësohet si disavantazh mospunësimi me një diplomë Bachelor në Matematikë, kjo evidente edhe për programe studimi të ngjashme brenda vendit. Vihet re një përpjekje e stafit akademik të departamentit për përdorimin e literaturës bashkëkohore megjithatë ka vend për përmirësim. GVJ evidenton se në disiplinat matematikore zhvillohen vetëm leksione dhe seminare me përjashtim të lëndës Analizë Numerike dhe sugjeron që të shtohen edhe orë</i>

	laboratorike, sidomos në lëndët Probabilitet-Statistikë të cilat mundësohen nëpërmjet softveve kompjuterike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nga informacioni dhe takimi i zhvilluar me NJSBCVI, GVJ arriti në përfundimin se ekzistojnë përpjekje të vazhdueshme me qëllimi përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Sektorit të kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve. Evidencë janë dy strategji të hartuara nga USH 2017 dhe 2022, Strategjia e tregut të punës dhe Strategjia e zhvillimit, të cilat përgjithësisht nuk kanë një plan pune për arritjen e objektivave. <b>Evidenca:</b> <b>Strategjia e tregut të punës 2017/ Strategjia e tregut të punës 2022</b> <b>Strategjia e zhvillimit 2017/ Strategjia e zhvillimit 2022</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	<i>Nga vizita dhe takimi me strukturat përgjegjëse GVJ evidentoi se universiteti ka pak praktika për konsultimin e vazhdueshëm me studentët e diplomuar me qëllim përmirësimin e programit të studimit. Nga biseda me studentët u la të nënkuptohej se kjo është një çështje e cila ka nevojë për përmirësim.</i>  <b>Evidenca:</b> <a href="https://unishk.edu.al/bashkepunimi-nderkombetar/bashkepunime">https://unishk.edu.al/bashkepunimi-nderkombetar/bashkepunime</a>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se modeli i përdorur për hartimin e syllabuseve, në programin e studimit Bachelor Matematikë përmban të gjithë elementet sipas përcaktimeve VKM nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2.8. Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literaturë ndihmëse.  <b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2022-2025.</b>
<b>Konkluzione</b>	<i>Në rastin e programi të studimit Bachelor Matematikë nuk ka evidencë për marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara, fakt që justifikohet pasi në planin mësimor të këtij programi nuk kryhet praktikë profesionale.</i>

	<i>Vihet re një përpjekje e stafit akademik të departamentit për përdorimin e literaturës bashkëkohore megjithatë ka vend për përmirësim.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	






### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në Syllabuset Bachelor në Matematikë, <i>Planin strategjik Matematikë</i> dhe bisedat me personelin akademik të departamentit, si edhe me studentët u konstatua se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë; VKM 41, dt. 24.01.2018) dhe kategorizohen në leksione, seminare, laboratore, detyra kursi/projekte, leksione të hapura nga profesorë të ftuar. etj.</p> <p>Në programin e studimit Bachelor Matematikë nuk ka të përfshirë Praktikë Profesionale.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Plani mësimor Bachelor Matematikë/ Syllabuset e lëndëve 2022-2025. Plani strategjik Matematikë</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjykon se përmbushja e këtij kriteri nga stafi i Departamenti të Matematikës garantohej nga takimi me studentët, të cilët shpreheshin për një gatishmëri të pedagogëve për t'ju afruar skema dhe metodologji inovative, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi, dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> <p>Një vlerësim sasior në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri gjendet Analizën e pyetësorëve Matematikë, ku ka evidencë është kryer një pyetësor për programin Bachelor Matematikë.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Analizën e pyetësorëve FSHN</b> <b>Analizën e pyetësorëve Matematikë, FSHN</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në shkëmbimet Erasmus+ GVJ gjeti dëshmi që institucioni nxit pedagogët në kryerjen e shkëmbimit për trajnimeve dhe mësimdhënies kryesisht me IAL Italiane. Nga dokumentacioni si dhe nga biseda me stafin akademik të departamentit, mbështetja e institucionit garantohej edhe nëpërmjet financimit total të pjesëmarrjes në konferenca shkencore jashtë vendit dhe pagesës së botimeve në buletine shkencore.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Lista e marrëveshjeve të USH.</b> <a href="https://unishk.edu.al/bashkepunimi-nderkombetar/erasmus">https://unishk.edu.al/bashkepunimi-nderkombetar/erasmus</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se stafi akademik i Departamentit të Matematikës ka në përbërje të tij pedagogë të kualifikuar në drejtimet kryesore të matematikës, që përkon me grupet mësimore-kërkimore të departamentit.</p> <p>Nga vizita në institucion departamenti disponon një laborator me pajisje teknologjike, si kompjutera të pajisur me softë efikase për matematikën si MATLAB, Matematica etj si dhe një tabelë interaktive,</p>

qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	e cila mundëson përdorimin e këtyre softeve për ndërtimet e figurave gjeometrike si dhe kryerjen e transformimeve gjeometrike me qëllim nxitjen e veprimtarisë së studentëve, duke i bërë ato aktivë dhe qëndër në zhvillimin e orës së mësimit. Ndërveprimi student-pedagog duket të jetë një kriter i përmbushur. <b>Evidenca:</b> <a href="https://bush.unishk.edu.al/">https://bush.unishk.edu.al/</a>								
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Matematikës ( <i>Analiza e pyetësorit</i> ) dhe bisedat me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se stafi i Departamentit të Matematikës diskuton në mënyrë periodike përmirësimin e formave të mësimdhënies, duke konsideruar kërkesat, rekomandimet dhe sugjerimet e studentëve, një evidencë është përshtatja e programeve të lëndëve Analizës matematike dhe Gjeometrisë për t'iu përshtatur ndryshimeve të ndodhura në kurrikulën e sistemit parauniversitar. <b>Evidenca:</b> <b>Raporti vjetor i Punës mësimore-shkencore për periudhën në Departamentin e Matematikës</b>								
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ nga evidencat e aktivitetit kërkimor dhe shkencor të personeli akademik të Departamentit të Matematikës evidenton si ai kualifikohet në mënyra të vazhdueshme sipas fushave të kërkimit shkencor të cilave ato ju përkasin. Institucioni ka garantuar mbulimin financiar të pjesëmarrjeve në konferenca ndërkombëtare dhe botime në revista shkencore, gjë e cila ka nxitur kualifikimin shkencor të stafit akademik. <b>Evidenca:</b> <b>Raporti vjetor i Punës mësimore-shkencore për periudhën në Departamentin e Matematikës</b> <b>Plani strategjik Matematikë</b>								
<b>Konkluzione</b>	GVJ arrin në përfundimin se ky kriter përmbushet plotësisht dhe ekziston vullneti i stafit për të vijuar më tej kualifikimet.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale	Mbështetur në dokumentacionin e miratuar nga USH siç janë: Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë dhe Rregullorja e Departamentit të

<p>përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Matematikës janë të përcaktuara kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive e dijeve dhe aftësive profesionale. Studentët orientohen nga Këshilltari akademik se ku mund të gjejnë këtë informacion, orientohen prej sekretareve, zyrës së studentit në rrjete të ndryshme sociale.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e USH.</b>  <b>Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës.</b>  <b>Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë.</b>  <b>Syllabuset Bachelor në Matematikë</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Departamenti i Matematikës dhe veçanërisht nga takimi me studentët e programit Bachelor Matematikë konstatoi se këto të fundit prezantohen me njohjen e kriterëve dhe mënyrave të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale që në orën e parë të çdo lënde/moduli me prezantimin e syllabusit prej pedagogut të lëndës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e FSHN-së.</b>  <b>Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës.</b>  <b>Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë.</b> <b>Syllabuset Bachelor në Matematikë</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Referuar syllabuseve të secilës lëndë ku përshkruhen në detaje format e testimit dhe vlerësimit të dijeve, përgjithësisht GVJ gjykon se formati i syllabusit është konform VKM 41 dhe studentëve ju ofrohen mënyra të ndryshme të testimit. Ka lëndë që vlerësohen me vlerësim të vazhdueshëm, por dominojnë ato me vlerësim me provim, por vlerësimi është ndarë në përqindje proporcionale, ku vlerësohet frekuentimi, aktivizimi dhe kontrollat e pjesshme, skema që u japin studentëve mundësinë për të demonstruar njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të lëndës ose modulit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e USH.</b>  <b>Syllabuset Bachelor në Matematikë</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/ Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ nga evidencat e aktivitetit kërkimor dhe shkencor të personeli akademik të Departamentit të Matematikës evidenton si ai kualifikohet në mënyra të vazhdueshme sipas fushave të kërkimit shkencor të cilave ato ju përkasin. Institucioni ka garantuar mbulimin financiar të pjesëmarrjeve në konferenca ndërkombëtare dhe botime në revista shkencore, gjë e cila ka nxitur kualifikimin shkencor të stafit akademik.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Raporti Vjetor i punës mësimore-shkencore</b>  <b>Rimbursimi i personelit akademik për kërkimin shkencor në DM</b>  <b>Plani Strategjik i Matematikës</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme</p>	<p>Një evidencë e qartë për përmbushjen e këtij kriteri GVJ gjen mbështetjen e institucionit për personelin akademik në pjesëmarrje në projektet kërkimore e në mënyrë të veçantë në mobilitetet Erasmus +, kjo drejtpërdrejt ndikon në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>

të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<b>Evidenca:</b> <b>Marrëveshjet institucionale.</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Për përmbushjen e këtij kriteri referuar dokumentacioneve të vëna në dispozicion si dhe diskutimeve të organizuara me stafin akademik të Departamentit të Matematikës ka evidenca të qarta dhe të matshme që të evidentojnë plotësimin e këtij kriteri.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b> <b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar “Rregullore e Departamentit të Matematikës”, “Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë” dhe syllabuseve të lëndëve si dhe nga bidesa që GVJ zhvilloi me stafin akademik të departamentit konstatoi se në përgjithësi vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: provimi i pjesshëm me peshë që varion nga 25-30%, dhe provimi përfundimtar rreth 65-70%. <b>Evidenca:</b> <b>Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë,</b> <b>Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	GVJ nuk gjeti evidenca për ekzistencën e një sistemi elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve, por USH ka një marrëveshje me AADF për programin CleanScore, me anë të të cilit parashikoet edhe testimi elektronik i studentëve. <b>Evidenca:</b> <b>Marrëveshja AADF dhe USH.</b>
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga kontrolli i disa procesverbaleve të vëna në dispozicion nga Kryetarja e Degës Mësimore, GVJ arriti në konkluzionin se komisionet e provimeve përbëhen nga 2 (dy) anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Tezat e provimeve përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm siç janë emri i studentit/tes, kodi i lëndës, emri i pedagogut, pikëzimin e pyetjeve etj. Tezat e provimeve hartohen nga titullari i lëndës dhe firmosen nga Përgjegjësjja i departamentit. <b>Evidenca:</b> <b>Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë.</b>

	<p><b>Model ngritje komisioni ankimimi.</b> <b>Vendim ankimimi.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Referuar Rregullores së USH/FSHN, dhe takimeve me studentët, pas përfundimit të provimit, studenti/tja ka të drejtë të ri-shikojë provimin dhe vlerësimin e dhënë nga titullari i lëndës. Vlerësimet janë të shoqëruara me komente dhe këshilla që e ndihmojnë studentin/ten në procesin e të nxënit.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/ nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Universitetin ‘Luigj Gurakuqi’, Rregulloren e Departamentit të Matematikës, Rregulloren e programit të studimit si dhe Kodin e Etikës së Universiteti të Shkodrës në rastet e konstatimeve të kopjimeve në provime apo detyrat e kursit, personeli akademik i tërheq studentit/tes vërejtje me gojë dhe i zeron pikët e vlerësimit.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Rregulloren e USH.</b> <b>Rregulloren e Departamentit të Matematikës, Rregulloren e programit të studimit.</b> <b>Kodi i Etikës i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër (2009).</b> <a href="https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati#c181">https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati#c181</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Referuar Rregullores së programit të studimit Bachelor Matematikë si dhe Kodin e Etikës së USH dhe takimeve me studentët konstantohet se ata mund të marrin vlerësimin e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale brenda 48 orëve nga dita e zhvillimit të provimit.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Rregulloren e USH.</b> <b>Rregulloren e Departamentit të Matematikës,</b> <b>Rregulloren e programit të studimit.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga takimi me studentët arriti në përfundimin se studentët njihen me vlerësimin sipas formave të përcaktuara në syllabusin e lëndës, dhe në raste paqartësish, ata shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, në raste mosdakortësie i drejtohen me anë të një kërkesë me shkrim përgjegjëses së departamentit.</p> <p>Studentët kanë akses dhe përdorin sistemin elektronik për tu njohur me arritjet e tyre akademike <a href="https://ushk.pitagora.rash/login">https://ushk.pitagora.rash/login</a></p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Rregulloren e USH.</b> <b>Rregulloren e Departamentit të Matematikës,</b> <b>Rregulloren e programit të studimit.</b> <a href="https://ushk.pitagora.rash/login">https://ushk.pitagora.rash/login</a></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga</p>	<p>GVJ nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga takimi me studentët arriti në përfundimin se studentët njihen me vlerësimin sipas formave të përcaktuara në syllabusin e lëndës, dhe në raste paqartësish, ata shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, në raste mosdakortësie i drejtohen me anë të një kërkesë me shkrim përgjegjëses së departamentit.</p> <p>Studentët kanë akses dhe përdorin sistemin elektronik për tu njohur me arritjet e tyre akademike <a href="https://ushk.pitagora.rash/login">https://ushk.pitagora.rash/login</a></p> <p>Sa u shpreh në Kriterin 8 si dhe referuar përcaktimeve për raste ankimimesh dhe ngritjen e kominsioneve të posaçme të shprehura në <i>Rregulloren e FSHN</i>, studenti ka të drejtë të ankimojë në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Nëse Përgjegjësi i Departamentit merr një kërkesë ankimi, duhet që brenda 48 orëve ti japë përgjigje</p>

komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	ankimimit, në rast të kundërt ia drejtoj ankimimin Dekanit, i cili ngrë një komision ad-hoc dhe kryen shqyrtimin e rastit. <b>Evidenca:</b> <b>Rregullore e FSHN.</b> <a href="https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati#c181">https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati#c181</a> <a href="https://ushk.pitagora.rash/login">https://ushk.pitagora.rash/login</a>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ sugjeron që në pyetësorët e hartuar të ketë pyetje të cilat marrin gjykimin e studentit në lidhje me rezultatet e kontrollit si dhe një analizë sasiore në lidhje me këtë çështje			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngrë struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Referuar Kurrikula Bachelor Departamentit Matematikës 2022-2025, Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë, GVJ arriti në konkluzionin se programi i studimit Bachelor në Matematikë është i hartuar për arsimimin profesional dhe formimin shkencor të studentëve në të gjitha disiplinat e matematikës, Analizë matematikë, Algjebër, Gjeometri, Probabilitet, Statistikë dhe Analizë numerike. I gjithë programi realizohet në 23 lëndë dhe synon thellimin e njohurive dhe aftësimin profesional të tij. <b>Evidenca:</b> <b>Kurrikula Bachelor DM 2022-2025</b> <b>Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë.</b>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Referuar Kurrikulës së programi të studimit Bachelor Matematikë vihet re një ndërthurjeje e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, dhe plotësuese. Në Planin mësimor të programit në fjalë gjenden lëndët Teknologjisë së Informacionit , Fizikë dhe Gjuhë e Huaj. <b>Evidenca:</b> <b>Kurrikula Bachelor DM 2022-2025</b> <b>Syllabuset e programit Bachelor në Matematikë.</b>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Referuar raportit të publikuar nga NJSBC dhe takimit të organizuar në UV, GVJ konstatoi se Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Matematikës, në mënyrë specifike strukturat përgjegjëse: Zv/Dekani për anën akademike, Drejtuesi i Departamentit, janë përgjegjës dhe bashkërendojnë procesin për kontrollin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. <b>Evidenca:</b> <b>Manuali i sigurimit të cilësisë</b> <a href="https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati#c181">https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati#c181</a>
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë	Një evidencë e qartë për përmbushjen e këtij kriteri GVJ gjen mbështetjen e institucionit për personelin akademik në pjesëmarrje në

kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	projektet kërkimore e në mënyrë të veçantë në mobilitetet Erasmus +, kjo drejtpërdrejt ndikon në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.			
	<b>Evidenca:</b> <b>Lista e mobiliteteve të stafit akademik të FSHN-së</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Për përmbushjen e këtij kriteri referuar dokumentacioneve të vëna në dispozicion si dhe diskutimeve të organizuara me stafin akademik të Departamentit të Matematikës nuk ka evidenca të qarta dhe të matshme që të evidentojnë plotësimin e këtij kriteri.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ sugjeron përfshirjen e me shumë lëndëve nga Matematikë së Aplikuar, lëndëve me karakter ekonomik, me qëllim që studentëve tu jepet mundësi e diversifikimit të studimeve në ciklin e dytë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Mbështetur në dokumentacionin e miratuar nga USH siç janë: Rregulloren e Universitetit, e cila është e publikuar online në faqen zyrtare të Universitetit ( <a href="https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuesc/rektorati#c181">https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuesc/rektorati#c181</a> ); Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë dhe Rregullorja e Departamentit të Matematikës janë të përcaktuara kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive e dijeve dhe aftësive profesionale. Studentët orientohen nga Këshilltari akademik se ku mund të gjejnë këtë informacion, orientohen prej sekretareve, zyrës së studentit në rrjete të ndryshme sociale. Referuar Rregullores së programit të studimit Bachelor Matematikë, është konstatuar se institucioni ka një procedurë të posaçme për mbrojtjen e diplomës, me të cilën studentët njihen në fillim të semestrit

	<p>të pestë dhe është publike edhe në faqen e fakultetit. Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Matematikë diplomohen me provim ose punim diplome. Periudha e diplomimit është dy herë në vit në sesionin e verës dhe në sesionin e vjeshtës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e FSHN/USH.</b>  <b>Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës.</b>  <b>Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në Matematikë,</b>  <b>Syllabuset Bachelor në Matematikë</b>  <a href="https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati#c181">https://unishk.edu.al/universiteti/autoritetet-dhe-organet-drejtuese/rektorati#c181</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në koherencë me Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë, sekretaria mësimore informon studentin në lidhje me shlyrjen e detyrimeve hyrëse në provimin e diplomës, ndërsa pedagogu udhëheqës ju vënë në dispozicion studentëve një material përmbledhës në lidhje me tezen e provimit të diplomës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë</b>  <b>Rregullore për testimet e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në evidencat e vënë në dispozicion “Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Matematikë”, GVJ konstaton se komisioni i posaçëm i ngritur për administrimin e provimit final formulon tezën e Provimit të Diplomës të programit të Ciklit të Parë Bachelor në Matematikë. Lista e pyetjeve të tezës bazohet në lëndët karakterizuese të programit të zhvilluara në 3 (tre) vite akademike, sipas peshës specifike në kredite që ka secila prej lëndëve. Teza firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë</b>  <b>Rregullore për testimet e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit,</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga evidencat dokumentacionale si dhe nga biseda me studentët rezulton se këto të fundit njihen me bandën e pyetjeve dhe literaturës së domosdoshme për përgatitjen për provimin e diplomës. Ky material tërhiqet nga studentët në sekretarinë mësimore ose drejtpërsëdrejti nga pedagogët gjatë seancave të konsultimit. Studentët me mesatare të lartë zgjedhin për të punuar temë diplome.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Programi i provimit të formimit Matematika 2022-2023.</b></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga biseda me studentët, GVJ u informua se studentët të cilët përzgjidhen për të zhvilluar një temën e diplomës kanë mundësinë të shfrytëzojnë bazën e të dhënave (informacion/statistika) të institucioneve të tjera, kryesisht brenda Shkodrës me të cilat universiteti (Fakulteti i Shkencave të Natyrës) bashkëpunon për realizimin e praktikave të studentëve.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të procesit të provimit, komisioni hedh rezultatet me shkrim dore në proces-verbalin përkatës, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Provimit. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Për studentët të cilët mbrojtjen e diplomës e realizojnë nëpërmjet prezantimit të një teme të punuar nën drejtimin e pedagogut udhëheqës, në përfundim juria pasi merr në konsideratë vlerësimin e udhëheqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë.</p> <p><b>Evidencë:</b> <b>Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Matematikë.</b> <b>Procedurë diplomimi në Departamentin e Matematikës.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Referuar Rregullores së organizimit të programit Bachelor në Matematikë studentët të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare pajisen me diplomë (Diplomë Bachelor në Matematikë), certifikatën e notave dhe suplementin e diplomës (Suplementit të Diplomës Bachelor në Matematikë). Të tri këto dokumente kanë formën e tyre të miratuar nga Senati akademik i Universiteti ‘Luigj Gurakuqi’, dhe të regjistruar në MASR. Referuar dokumentacionit dhe praktikës së treguar nga Kryetarja e Degës mësimore gjatë takimit të zhvilluar online, si dhe në vijim të shpjegimeve të dhëna në Kriterin 8, student pasi shlyen të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, pasijet me diplomë dhe suplementin e diplomës. Në rast se ai është i interesuar për kopjen e plotë të programit të studimit që ka ndjekur i drejtohet Degës Mësimore me një kërkesë me shkrim dhe nis përgatitja e programit të plotë. Programin e plotë student i diplomuar mund ta kërkojë në raste specifike, kur i kërkojnë për të ndjekur një program studimi në një cikël më të lartë, transferim studimesh, etj.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Suplementit të Diplomës Bachelor në Matematikë</b> <b>Diplomë Bachelor në Matematikë</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Referuar LAL 80/15, Statutin e USh-së, Rregulloren e USh-së, sekretaria mësimore e departamentit dhe e FSHN-së disponojnë dokumentacionet: regjistër themeltar, regjistër të lëshimit të diplomave. Dega mësimore përgatit certifikatën e notave, ku janë të paraqitura të gjitha notat dhe të dhënat e studentit, përfshirë numrin e matrikullimit. Suplementi i diplomës është i hartuar me të gjitha elementet e përcaktuara në VKM 41. Konfirmimi i dokumentacionit, i cili kërkohet në rastet kur studentit duhet të legalizojë ose të aplikojë</p>

	jashtë vendit, ndjek të gjitha hallkat ku ai ka kaluar për prodhimin e tij, në të cilat firmoset dhe vuloset. <b>Evidenca:</b> <b>Rregullore e USh-së.</b> <b>Statuti i USh-së.</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ gjykon se procedurat ndiqen me rigorozitet dhe janë në pasqyruar anë rregulloret përkatëse.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Standardi IV.1**

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																																																
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në RVB, takimin me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, GVJ konstaton se administrimi i bazës së të dhënave mbi personelin akademik, ndihmës mësimor, shkencor dhe administrativ, bëhet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit në Universitetin e Shkodrës. Këto të dhëna ruhen për çdo vit akademik, për gjithë stafin akademik që përfshihet në program. Këto të dhëna, përmbajnë emrat e stafit akademik, lëndët për çdo semestër, orët mësimore dhe ngarkesën totale si dhe statusin e tij. Nga analiza e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se ky personel ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Gjithashtu, fusha kërkimore është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve. Përgjegjësi i departamentit mbledh, arkivon dhe përditëson çdo vit CV për të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ të përfshirë në programin e studimit, për ta realizuar atë. Në departament gjenden të arkivuara dosje me CV të pedagogëve. Këto CV gjenden gjithashtu të depozituara dhe arkivuara edhe pranë zyrës së Burimeve Njerëzore të Universitetit. Kriteri, personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës, plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p> <table border="1" data-bbox="699 1308 1394 1644"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>5</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>8</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>8</b></td> <td><b>12</b></td> <td><b>5</b></td> </tr> </tbody> </table> <p><b>Evidenca:</b> CV e pedagogëve Tabelat përmbledhëse e BSc. Matematike</p>	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	-	1	-	1	-	-	Prof. Asoc.	-	-	-	-	3	0	Dr/Phd	4	-	4	-	4	1	Msc.	5	7	5	7	5	4	<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>8</b>	<b>12</b>	<b>5</b>
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof. Dr	-	1	-	1	-	-																																											
Prof. Asoc.	-	-	-	-	3	0																																											
Dr/Phd	4	-	4	-	4	1																																											
Msc.	5	7	5	7	5	4																																											
<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>8</b>	<b>12</b>	<b>5</b>																																											
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar RVB, Universiteti i Shkodrës garanton transparencën ndaj publikut, paanshmërinë, shanse të barabarta të konkurimit dhe zbatim rigoroz të kriterëve ligjore të parashikuara në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 64, Pika (1) dhe Kodit të Punës. Kriteret e përgjithshme parashikohen nga Rregullorja e Fakultetit.</p>																																																

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 27





	<p>Kriteret specifike të punësimit të personelit akademik përcaktohen nga njësia bazë, në bazë të nevojave dhe miratohen nga rektori.</p> <p>Vendit vakant shpallet në Buletinin e Njoftimeve Publike (VKM Nr.176. dt. 29.03.2006 "Per botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike") dhe në faqen web të Universitetit. Kandidatëve potenciale ju jepet mundësia të paraqesin dokumentacionin brenda afateve të përcaktuara. GVJ konstaton se personeli akademik me kontratë është i kufizuar në numër krahasimisht me personelin akademik efektiv. Bazuar në tabelat përmbledhëse, për vitin akademik 2022-2023 ngarkesa mësimore është realizuar në masën 90% nga personeli akademik efektiv (PAE).</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore të ndryshme punësimi dhe përzgjedhja e stafit USH</b>  <b>Rregullore e Fakultetit</b>  <b>Kodi i Etikes USH</b>  <b>Tabelat përmbledhëse e BSc. Matematike</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni ka procedura për zhvillimin e cdo procesi e veprimtarie Ai mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat mbi personelin akademik, ndihmës mësimor, shkencor dhe administrativ. Kjo bazë të dhënash, e personelit të angazhuar në realizimin e programeve të studimit përfshin kontratat e punës konform legjislacionit dhe akteve të tjera të brendshme, CV akademike, organizimin e kohës vjetore të punës, planin e ngarkesës mësimore, dosjet e pedagogëve, etj. Nga takimet me përfaqësues të sektorit të Burimeve Njerëzore GVJ u informua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e studimit ka lidhur kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë Asistent lektor dhe me afat të pacaktuar për kategoritë Lektor dhe Profesor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Si institucion publik, USH garanton dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik të punësuar. Personeli akademik me kontratë angazhohet mbi bazën e kontratave vjetore ose semestrale.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Tabela përmbledhëse BSc. Matematike, USH</b>  <b>Takimi në institucion me Zyrën e Burimeve Njerëzore</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedura për rekrutimin e personelit pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi" administrohet nga Drejtoria Juridike dhe të Burimeve. Pas publikimit të shpalljes së vendit vakant në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen web të Universitetit, kandidatëve potenciale ju jepet mundësia të depozitojnë dokumentacionin përkatës brenda afatit të përcaktuar në njoftim. Kriteret e punësimit sanksionojnë zhvillimin e një konkursi publik, të hapur dhe të paanshëm. Në Statutin e USH, Kreu V, Neni 40 përcaktohet procedura e rekrutimit, e zhvillimit të konkursit, si dhe e ngritjes së Komisionit Ad Hoc. Kompetenca themelore e këtij komisioni të posaçëm është shqyrtimi i pajtueshmërisë së dokumentacionit të depozituar nga ana e kandidatëve, me kriteret e përgjithshme të</p>

	<p>përcaktuara në ligj dhe rregullore, dhe kriteret specifike të përcaktuara nga njësia bazë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e Universitetit</b>  <b>Takimi në institucion me Zyrën e Burimeve Njerëzore</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion dhe takimit me drejtorinë Juridike të Burimeve Njerëzore rezulton se mënyra e vlerësimit të kandidatëve, që punësohen si personel akademik, realizohet sipas dokumentacionit në fuqi. Përsa i përket rekrutimit të pedagogëve me kohë të pjesshme, procedura paraprihet nga një mbledhje e zhvilluar në nivel departamenti. Departamenti diskuton shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe propozon kriteret specifike që kanë në bazë specialitetin, disiplinën dhe kualifikimin.</p> <p>GVJ vizitoi ambientet dhe laboratorët. Nga shqyrtimi i CV të personelit ndihmës-akademik që kontribuon në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Matematike”, GVJ konstaton se kemi të bëjmë me personel ndihmës-akademik me kualifikim të mjaftueshëm. Në këtë mënyrë disponohet niveli i duhur për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua për kontributin nga ana e këtij personeli edhe në mirëmbajtjen e laboratorëve etj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Tabela përmbledhëse Bachelor Matematike, Tabela 1, Tabelat 2, Tabela 16</b>  <b>CV e stafit ndihmës akademik FSHN</b>  <b>Vizita e GVJ në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyrat përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ, në USH, janë zyra e Burimeve Njerëzore dhe zyra e Arkiv-Protokollit. GVJ zhvilloi takim me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore. GVJ konstatoi se kjo zyrë bashkërendon punën e saj me njësitë bazë në fakultete në lidhje me përditësimin e të dhënave të stafit akademik. Përsa i përket informacionit në lidhje me angazhimin e çdo anëtari të personelit akademik dhe ndihmës akademik në çdo semestër dhe vit akademik, ky informacion administrohet nga Fakulteti si dhe nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Çdo vit akademik përditësohen CV e pedagogëve, ku pasqyrohen veprimtaritë kërkimore, publikimet dhe konferencat shkencore ku ai/ajo merr pjesë. Departamenti dhe NJSBC disponon ngarkesën mësimore të secilit pedagog/e për secilin semestër, si dhe oraret mësimore për pedagogët, bashkë me programet lëndore ku pedagogu/ja është titullar/e apo lektor/e e lëndës. Po ashtu, çdo fillim viti dhe semestri përcaktohet ngarkesa mësimore për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrative.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Vizita e GVJ në institucion</b>  <b>RVB e programit</b></p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>USH ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në rang universiteti. Janë disa marrëveshje me universitete kombëtare/ndërkombëtare institucione ose kompani.</p> <p>Studentët nuk kanë lëndë si praktikë profesionale por për shumë nga lëndët e formimit profesional ata zhvillojnë praktika të tyre në labororet e Fakultetit. Elementë praktikë të përvehtësimit të lëndëve shfaqen në kuadër të realizimit të programit përkatës si dhe në kuadër të temës së diplomës (për studentët që diplomohen me temë diplome).</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Laboratore USH</b> <b>Tabela permbledhese Bachelor Matematike, Tabela 5</b></p>			
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se, USH asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. Udhëheqësi i praktikës profesionale asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe është i pranishëm në komisionin e praktikës profesionale.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Plani Mesimor BSc. Matematikë</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Personeli akademik, i angazhuar në programin Bachelor në Matematikë, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Fusha kërkimore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve.</i></li> <li>- <i>Ngarkesa mësimore realizohet në masën më të madhe nga personeli akademik efektiv duke respektuar detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi.</i></li> <li>- <i>Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të mirëpërcaktuara dhe të pasqyruara në aktet rregullatore të USH.</i></li> </ul> <p><i>Në kurrikulën e programit të studimit Bachelor në Matematikë parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale. GVJ mendon se integrimi i saj në planin mësimor kontribuon në një formim më cilësor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB, vizita në institucion si dhe nga takimi me përgjegjësen e Departamentit, Dekanin dhe stafin akademik të programit të studimit, konstatohet se institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për personelin. Institucioni ka siguruar investime, të cilat ofrojnë mjedise të mirëpajisura për çdo anëtar të stafit akademik dhe administrat, që u krijojnë mundësi për realizimin e detyrave të tyre profesionale. Programi i studimit Bachelor në “Matematike”, i cili mbulohet nga Fakulteti i Shkencave Natyrore, ka në dispozicion, për realizimin e procesit mësimor, ambientet e duhura për zhvillimin si të leksioneve e seminareve ashtu edhe të seanceve laboratorike. Nga vizita në mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor, GVJ konstatoi se ato janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur. Sallat janë të pajisura me sistem qendror ngrohje dhe ftohje, për sigurimin e kushteve optimale në zhvillimin e mësimin. Institucioni ka dhe bibliotekën dhe l zyrë informacioni për studentë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Tabelat përmbledhëse: Mjediset e Fakultetit/ Njësive Bazë (Tabela 16)</b>  <b>Infrastruktura dhe ambjente</b>  <b>Vizita e GVJ në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Universiteti i Shkodres dhe më specifiku Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane mbështet stafin e tij për kualifikim të mëtejshëm. Institucioni promovon programe në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim, që kanë të bëjnë me sigurimin e të dhënave shkencore, përditësimin e materialit didaktik, pjesëmarrjen në konferenca e seminare kombëtare e rajonale, organizimin e konferencave etj. Stafi zhvillon takime të rregullta brenda departamentit si për vetë kualifikimin e tij, ashtu dhe për marrjen e vendimeve të rëndësishme që lidhen me mësimdhënien, studentët dhe probleme të tjera. Përdorimi i sitemit wireless të rrjetit është i shtrirë në të gjithë godinën dhe ofron suportimin e përdorimit të metodologjive të reja për mësimdhënien. Në ndihmë vijnë dhe sallat e laboratorëve IT të pajisur me tabela të teknologjisë inovative, me projektor dhe PC për zhvillimin e projekteve të ndyrshme, seminareve dhe praktikimin e gjuhëve të programimit. Për shkak të pandemisë Covid 19, rezultojnë se mbështetja e institucionit me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimin me metodat inovative, ka përmirësuar ndjeshëm mësimdhënien. Gjithashtu, përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie (Google, eduMeet, Google Meet, Google Classroom, Office 365 for Education) inkurajon në metoda të reja mësimdhënieje.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Infrastruktura dhe ambjente</b>  <b>Salla dhe Laboratore</b>  <b>Vizita e GVJ në institucion</b></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Godina e Fakultetit të shkencave të natyrës/Dega Matematike është e pajisur me mjete bashkëkohore për mësimdhënie. Çdo ambient mbulohet me sistemin wireless të internetit. Çdo sallë mësimore është e pajisur me kompjuter, videoprojektorë ose whiteboard etj. GVJ është e mendimit se kjo infrastrukturë informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Ambjente, salla dhe labore SH</b>  <b>Vizita e GVJ në institucion</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti ka tre laboratorë të pajisur me kompjutera, videoprojektorë, whiteboard dhe programet të ndryshme kompjuterike si (CodeBlocks, Matlab, Geogebra etj) të instaluar në kompjuterat e tyre. Pra, çdo student mund të ndjekë dhe të praktikojë njëkohësisht njohuritë e marra në lëndët përkatëse në lidhje me programet e mësipërme. Laboratorët e informatikës, janë të pajisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës. Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës akademik me kualifikimin e duhur.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Ambjente, salla dhe labore SH</b>  <b>Vizita e GVJ në institucion</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira. Laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</li> <li>- Infrastruktura informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</li> <li>- Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës akademik me kualifikimin e duhur.</li> </ul> <p>GVJ vlerëson se USH ka vënë në dispozicion të programit të studimit mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.3</b>  <b>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>






<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/ module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sipas axhendës për këtë qëllim u realizua një vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) si dhe vizitë në Bibliotekë dhe nga këto vrojtme u vu re se: USH ofron një infrastrukturë të plotë fizike, didaktike dhe logjistike, që ndihmon realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Auditorët mësimorë, laboratorët, ambjentet e personelit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe biblioteka janë mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për zhvillimin cilësor të veprimtarisë mësimore. GVJ u informua se literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme për vetë veçantinë e këtij programi janë kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht).</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Literatura ne biblioteke dhe marreveshje per biblioteken online</b>  <b>Tabelat përmbledhëse Të dhëna për platformat online/ Biblioteka (Tabela 17).</b>  <b>Vizita në biblioteke</b>  <b>Vizita e GVJ në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimi respektiv me përgjegjësin e Departamentit, u vu në dukje se syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit, përditësohen nga pedagogët sipas literaturës me botime të viteve të fundit. Syllabuset miratohen çdo fillim semestri në departament. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes se vetëvlerësimit, GVJ konstatoi se në përgjithësi në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Vizita e GVJ në institucion</b>  <b>Syllabuset Bachelor Matematike</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimeve me studentët u diskutua shfrytëzimi i bibliotekës fizike dhe asaj elektronike që USH vë në dispozicion në shërbim të procesit mësimor, edukativ, të formimit profesional dhe të veprimtarisë shkencore që kryhet në këtë fakultet. Ajo është e shfrytëzueshme në mënyrë të barabartë nga studentët e të gjitha programeve të studimit pa detyrim financiar. Godina e bibliotekës ka në përbërjen e saj edhe sallën e konferencave “Hoeflechner”, me një kapacitet 120 vende, e cila mundëson zhvillimin e një sërë aktivitetesh të karakterit akademik, mësimdhënës apo promovues.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Literatura ne biblioteke dhe marreveshje per biblioteken online</b>  <b>Tabelat përmbledhëse: Të dhëna për platformat online/ Biblioteka (Tabela 17).</b>  <b>Vizita në biblioteke</b></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Pas vizitës në bibliotekë sipas axhendës dhe dokumentacionit që na u vu në dispozicion u vu re se biblioteka disponon një fond që përbëhet prej rreth 111.000 libra ne gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Nga këto literatura një pjesë e konsiderueshme ishte në ndihmë të studentëve të programit të studimit Bachelor ne “Matematikë”. Biblioteka ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit. Biblioteka ofron për përdoruesit e saj një sërë shërbimesh si: shërbimin e informacionit dhe të huazimit, vë në dispozicion të tyre mediatekën, me 26 vende multimedia, si dhe tri salla leximi me 300 vende leximi në total. Ajo shkëmben informacion me biblioteka të tjera akademike brenda dhe jashtë vendit. Biblioteka zotëron koleksione të pasura si: fondin alban – balkanologjik, fondin shqip &amp; të shkencave filologjike të albanologjisë, fondin e huaj, bibliotekën austriake, fondin e periodikut (të serialëve) dhe fondin e fakulteteve. Risi për Bibliotekën Universitare të universitetit përbënte biblioteka austriake e hapur në mjediset e saj që në vitin 2000. Kjo bibliotekë numëronte rreth 14.000 libra dhe mbështetet nga Ambasada Austriake në Tiranë dhe pasurimi i fondeve realizohet çdo vit nga Ministria Federale e Punëve të Jashtme të Austrisë Online Public Access Catalog lejon kerkimin ne te gjithë fondin e BUSH. OPAC është i ndare në seksionet e meposhtme</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Albanologji / Balkanologji</li> <li>- Arkiva</li> <li>- Biblioteka Austriake</li> <li>- Fondi i fakulteteve</li> <li>- Fondi ne gjuhe te huaj</li> <li>- Fondi ne Shqip</li> <li>- Fondi i serialeve dhe materialeve referuese</li> <li>- Fondi i shtypit te shkruar</li> <li>- Mediateka</li> </ul> <p><b>Evidenca: Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita dhe takimi me përfaqësues të bibliotekës së USH, Biblioteka e USH-së ka në shfrytëzim platformën U-Library që mundëson rritjen e interaktivitetit të shërbimeve të bibliotekës me studentët në linkun <a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>. Ajo siguron shërbim dhe informacion bibliotekar falas dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit e bibliotekës. Biblioteka u ofron shërbim pedagogëve dhe studentëve përmes sportelit të huazimit, sportelit të informacionit, mediatekës, e cila është e pajisur me 30 vende multimedia (kompjuterat e kësaj salle janë dhuratë e Qeverisë Austriake dhe e Universitetit të Firences (përmes projektit Tempus Phare) si dhe tri sallave të leximit afërsisht me 300 vende leximi ku lexuesit e studiuesit mund të lexojnë e shfletojnë literaturë në qetësi të plotë. <a href="http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/">http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/</a>. Biblioteka Universitare Shkencore, siguron akses pa pagesë në burimet ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë nga: BioOne, Cambridge Journals Online, EBSCO Academic Search Complete,</p>

	<p>Emerald Engineering ejournal collection, OECD library etj., nërmjet projektit ERA 2012 (Elektronik Resources for Albania),</p> <p><b>Evidenca: Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka shërben njëkohësisht si sallë studimi, dhe siguron kompjutera, programe të instaluar me qëllim lehtësimin e procedurave të shkarkimit dhe upload të materialeve nga studentë dhe stafi akademik, pajisje të tjera teknike, internet pa limit, si dhe me sistem ngrohje për t'ju siguruar studentëve dhe pedagogëve kushte optimale (lexim, fotokopje të materialeve bibliotekare, etj). Në raste të caktuara studentët mund të shfrytëzojnë këto mjedise për të paraqitur prezantimet e detyrave dhe projekteve të kursit. Një shërbim mjaft cilësor realizohet ndaj përdoruesve të bibliotekës edhe përmes sallës së konferencave me 120 vende e njohur si salla "Walter Hoeflechner" në nderim të profesorit të Universitetit të Grazit që u përfshi me shumë pasion në projektin për bibliotekën e re. Kjo sallë është e parametrave bashkëkohore akademike ku mund të realizohen edhe video konferenca. Orari i shfrytëzimit të bibliotekës është i përshtatshëm për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimin. Por ato mund të aksesojnë online çdo kohë në platformat:</p> <p><a href="http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/">http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/</a>, <a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>, <a href="http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/">http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/</a></p> <p><b>Evidenca: Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Çdo student/pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Studenti disponon një kartelë regjistrimi me të dhënat personale dhe pajisjet me librezë anëtarësie. Ai ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave, për navigimin në burimet elektronike, ose përdorimin e katalogut elektronik. Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në Web-in e universitetit, nga e Hëna në të Premte: 08.00-19.00, ndërsa të Shtunën 08.00-13.00.</p> <p>Kapaciteti i stafit të bibliotekës është i tillë që përballon nevojat e studentëve për shërbim, apo edhe shfrytëzim të mjediseve për punë në grup apo prezantime. Numri i punonjësve të bibliotekës është 13 anëtarë si përgjegjës, klasifikator, bibliograf, bibliotekar. Kompetenca e tyre për të ofruar shërbime është e specializuar, pasi ato janë punonjëse që përveç diplomimit në një fushë të caktuar kanë përfunduar shkollën e bibliotekave, kanë njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit dhe gjuhëve të huaja kryesisht anglisht.</p> <p><b>Evidenca: Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli</p>	<p>Nga takimet, vizitat, që GVJ zhvilloi në institucion, vërehet një frymë bashkëpunimi mes departamenteve të bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës. Në dokumentacionin e ofruar rezulton një listë e pasur e materialeve (libra/artikuj shkencorë etj). Vetëm të viteve të fundit ajo ka rreth 500 tekste për Matematikën. Nga ana e drejtuesve të bibliotekës kërkohet çdo vit nga drejtuesit e fakultetit të shkencave të natyrës/ Departamenti Matemetike/ Seksioni Matemetike, dekan dhe përgjegjës departamenti një listë e detajuar</p>

<p>akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>për blerjen e librave të nevojshëm nga fondi i bibliotekës në mbështetje të programit të studimit dhe projekteve kërkimore-shkencore që përfshihen edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim. GVJ konstaton përpjekje të institucionit për pasurimin e bibliotekës dhe plotësimin e kërkesave të stafit akademik me libra.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Vizita GVJ në institucion</b>  <b>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Literatura bazë e programit të studimit Bachelor në Matematikë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme janë kryesisht në gjuhë të huaj.</i></li> <li>- <i>Biblioteka është në dispozicion të studentëve të programit të studimit gjatë gjithë javës në orarin 8:00 deri 16:00.</i></li> </ul> <p><i>Është siguruar akses në biblioteka online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelit akademik në një literaturë të përditësuar.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Shkodrës ofron faqen elektronike online <a href="https://unishk.edu.al/">https://unishk.edu.al/</a> ku studentet vihen në dijeni të njoftimeve, eventeve, orareve, datave të provimeve, etj. Platforma elektronike <a href="https://ushk.pitagora.rash/login">https://ushk.pitagora.rash/login</a> krijon lehtësi në sistemin e menaxhimit të të dhënave për studentët dhe stafin mësimdhënës. Aty studentët kanë mundësi të regjistrojnë orarin, të shohin rezultatet etj. Mbasi kandidati fiton statusin e studentit, regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm si edhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga MASR. Studenti regjistrohet në sekretarinë mësimore, pajiset me një llogari, e cila ka username dhe password personal për platformën online. Institucioni disponon faqen zyrtare web dhe programin e transparencës. Në këtë sistem janë të përfshira ndërfaqet për studentët, personelin akademik, sekretarinë mësimore dhe zyrën e financës për verifikimin e pagesave. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Evidenca: Vizita e GVJ në institucion</b></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>FSHN/USH e administron informacionin dhe dokumentacionin e tyre që lidhet me zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor nëpërmjet sistemit Pitagora dhe zyrës së Burimeve Njerëzore.</p> <p>Në Zyrën e Burimeve Njerëzore ruhen dhe administrohen informacione për personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Personeli akademik joefektiv nëse ka qenë i angazhuar një vit më parë në USH nuk është e nevojshme të sjelli gjithë dokumentacionin e aplikimit, por vetëm kërkesë, vërtetim page dhe vërtetime nëse ka pasur ndryshime në titujt akademik. Në sistemin Pitagora ruhet informacioni i personelit akademik të angazhuar në realizimin e programit të studimit për çdo vit akademik. Sistemi Pitagora i zhvilluar nga RASH ofron funksionalitete për administratën e sekretarisë të universitetit dhe përdoruesit fundor (studentëve, pedagogëve, etj) për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në syllabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj.</p> <p>Akcesi në sistemin Pitagora mundësohet nëpërmjet faqes web, ku propozohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Nëpërmjet këtij sistemi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj.</li> <li>- Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj.</li> <li>- Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj.</li> <li>- Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit dhe pagesave të kryera.</li> </ul> <p><b>Evidenca: Vizita e GVJ në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Që në vitin 2020 edhe në universitetin e Shkodrës funksionon platforma e integruar Microsoft Teams e cila ka ndihmuar shumë në procesin mësimor në të gjithë etapat e tij. Midis studentëve dhe personelit akademik ekziston një komunikim interaktiv, si fizik, student-staf akademik gjatë orës së mësimit, ashtu edhe jashtë saj. Sipas profileve të personelit dhe studentëve, sistemi Pitagora siguron module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit. Personeli ka informacion për studentët sipas profileve dhe degëve të studimit, për çdo modul ku është i aktivizuar. Në përfundim të zhvillimit të modulit ruan rezultatet e secilit student dhe ky informacion i komunikohet çdo studenti në profilet përkatëse. Përveç platformës Pitagora, nga ana e stafit akademik dhe studentëve përdoren gjerësisht edhe platforma të tilla si Google Classroom dhe MS Teams. Përdorimi i këtyre platformave mundëson transmetimin nga ana e pedagogëve të leksioneve,</p>

	<p>materialeve që lidhen me kërkesat e detyrave të kursit, zhvillimin e seancave laboratorike etj., si dhe postimin nga ana e studentëve të zgjidhjeve dhe realizimit të detyrimeve përkatëse.</p> <p>Informacione të detajuara për aktivitete të ndryshme, kuadrin ligjor, kërkimin shkencor, vendime të Senatit akademik dhe Rektoratit, transparencën, shërbime që ofrohen etj, jepen dhe në faqen web të USH.</p> <p><b>Evidenca: Vizita e GVJ në institucion</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Çdo përdorues në sistemin Pitagora ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në FSHN/USH. Gjithashtu, në dispozicion janë platformat Google Classroom dhe MS Teams dhe faja zyrtare e USH ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë. Sistemi Pitagora garanton në një masë të madhe monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, si ruajtja e monitorimi i pagesave nga zyra financiare për studentët, dhe mundësimin e raportimeve individuale dhe të dhënave në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët</p> <p><b>Evidenca: Vizita e GVJ në institucion</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen e universitetit janë të publikuara rregullisht informacionet në lidhje me Universitetin, strukturat e tij, për programet e studimit, për projektet apo oraret e provimeve ose mësimore të lëndëve, etj. Informacioni në faqen web ofrohet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Vizita e GVJ në institucion</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>USH disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional që bën edhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit Bachelor në Matematikë.</i></li> <li>- <i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre mbahet nga Sekretaria Mësimore dhe menaxhohet elektronikisht nëpërmjet sistemit.</i></li> <li>- <i>Sistemi Pitagora ofron funksionalitete për administratën e sekretarisë të universitetit dhe studentët, pedagogët, etj për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në kurse, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara.</i></li> <li>- <i>Studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore u mundësohet hyrje e dedikuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar</i></li> </ul> <p><i>Informacionet për programin Bachelor në Matematikë publikohen në dy gjuhë në faqen zyrtare të USH në seksionin e dedikuar për Fakultetin e Shkencve Natyrore.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Universiteti i Shkodrës harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tij. Universiteti për sa i takon financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare funksionon konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Raporti financiar i hartuar nga Drejtoria e Financës detajohet dhe paraqitet me zërat e kostove përkatëse për programet e cikleve të studimit Bachelor, Master Profesional dhe Master i Shkencave në rang fakulteti.</p> <p>Institucioni çdo vit, në mënyrë të rregullt, auditohet nga grupi i ekspertëve të auditit të brendshëm të institucionit. Tre janë burimet potenciale të financimit: financim nga buxheti i shtetit, financim nga tarifat e studentëve si edhe financim nga shërbimet që USH ofron për aktorë të tretë. Gjithashtu në relacionin afatmesëm të projekt buxhetit planifikohen edhe rrugët e financimit të investimeve duke identifikuar burimet e mundshme të gjenerimit të të ardhurave.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Raporti financiar i kostove te programit te studimit</b>  <b>Statuti i USH</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Tabelat permbledhese (Tabela 18)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstaton se në raportimin e publikuar nga USH janë të pasqyruara në nivel institucioni plani dhe realizimi i financimeve për burimet njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. Në Statutin e USH përcaktohet edhe burimet e financimit të institucionit. Burimet kryesore të financimit për këtë program studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Buxheti i Shtetit.</li> <li>➤ Pagesat e studentëve për arsimim.</li> <li>➤ Të ardhurat për shërbimet e kryera.</li> <li>➤ Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta.</li> <li>➤ Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi.</li> <li>➤ Veprimtari kërkimore – shkencore.</li> <li>➤ Projekte lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> </ul>
	<p>Vihet re se pjesa dërmuese e financimit vjen nga buxheti i shtetit, ndaj duhen bërë përpjekje në veçanti për rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim dhe kontratat.</p>




	<b>Evidenca:</b> <b>Statuti i USH</b> <b>RVB e programit</b> <b>Tabelat permbledhese (Tabela 18)</b>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni auditohet çdo vit nga audimi i brendshëm. Burimet e financimit janë nga buxheti i shtetit, tarifa studentësh etj. Universiteti bën të njohur pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera për të pasur transparencë ndaj publikut. <b>Evidenca: Statuti i USH</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Hartohet edhe raporti i analizës financiare në mënyrë periodike për vitet e kaluara akademike për të treguar eficientë në përdorimin e të ardhurave dhe menaxhimin e shpenzimeve për të përmirësuar punën në të ardhmen. <b>Evidenca: Statuti i USH</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	GVJ konstaton se nga të dhënat e tabelave përmbledhëse, mungon informacion mbi tabelen për të ardhurat dhe financimet për tre vitet e fundit.  <b>Evidenca:</b> <b>Tabelat permbledhese (Tabela 18-mungon)</b>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konstaton se: - Pjesa më e madhe e financimit vjen nga buxheti i shtetit, ndaj duhen bërë përpjekje për rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim dhe kontratat. - Nuk ka një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit. - Mungon informacion mbi tabelen për të ardhurat dhe financimet për tre vitet e fundit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi mbështetet në Statutin e USH, Rregulloren e USH, Rregulloren e FSHN dhe Rregulloren e programit të studimit. Në rregulloren e USH-së ka politika dhe procedura në përputhje me legjislacionin në fuqi që mbulojnë këto aspekte. Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat që mundësojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi e kompetenca profesionale dhe analitike. Kriteret e pranimit të studentëve përcaktohen nga MASR (udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës), statuti dhe rregullorja e studimeve të FSHN dhe USH. Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Bachelor është 3 vite akademike. Numri total i krediteve që duhet të grumbullojë një student për finalizimin e këtij cikli studimi është 180 ECTS. Studentët e këtij programi studimi diplomohen me provim diplome ose tezë diplome. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma përkatëse. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e FSHN zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Statuti i USH</b>  <b>Rregullore e USH</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>Rregullore e Programit BSc. Ne Matematike USH</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja e USH përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve apo transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit. Këto politika sigurojnë informim për kriteret, procedurat dhe afatet e aplikimit (duke përfshirë këtu edhe tarifat përkatëse të programit), transferimit dhe përfundimit të studimeve. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga Departamenti i Matematikës dhe drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e USH</b>  <b>Rregullore e FSHN</b></p>

	<b>Rregullore e Programit BSc. Ne Matematike USH</b>																
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e pranimit dhe vazhdimësisë të studimeve, transferimit nga një program studimi në një tjetër, njohjes së studimeve të kryera në një program tjetër (i plotë apo i pjesshëm apo edhe i realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit CEEPUS e Erasmus, por jo vetëm) përcaktohen qartë në rregulloren e fakultetit dhe atë të programit të studimit. Ky informacion bëhet publik nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit në seksionin përkatës të FSHN, Departamenti Matematike. Për tre vitet e fundit akademike regjistrimet për programin e studimit Bachelor në Matematikë kanë qënë si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="635 577 1417 824"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th> <th>Studentë të transferuar sipas viteve</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>9</td> <td>0</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>5</td> <td>0</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>9</td> <td>0</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table> <p>Kriteret e pranimit shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Vendim Senati per Kuotat</b>  <b>Vendim Senati për Kriteret e Pranimit te Studenteve</b>  <b>Rregullore e Programit BSc. Ne Matematike USH</b></p>	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali	2020-2021	9	0	9	2021-2022	5	0	5	2022-2023	9	0	9
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali														
2020-2021	9	0	9														
2021-2022	5	0	5														
2022-2023	9	0	9														
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë të studimeve në USH përcaktohen nga MASR (udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës), statute dhe Rregullorja e studimeve të FSHN dhe USH.</p> <p>Rregulloret e institucionit, njësisë kryesore dhe programit të studimit kanë informacion të plotë për kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Këto informacione studentët mund ti gjejnë në zyrat përkatëse në institucion, faqen zyrtare të USH dhe në rrjetet sociale të FSHN/USH.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e USH</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>Rregullore e Programit BSc. Ne Matematike USH</b></p>																
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti që mbulon programin përkatës të studimit komunikon me publikun në këtë drejtim nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, njoftimeve në stendat e fakultetit, takimeve me studentë të nivelit Bachelor të sapodiplomuar etj. Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen web përpara fillimit të vitit akademik. Referuar takimeve në institucion, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe</p>																




<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit Bachelor në Matematikë.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se kanë të drejtë të kandidojnë për pranim në programin e studimit Bachelor në Matematikë kategoritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kandidatët që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM.</li> <li>- kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj.</li> <li>- shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.</li> <li>- si dhe personat që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe aplikojnë për program të dytë studimi.</li> </ul> <p>Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara hartohen duke u bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe në formimin që marrin studentët në maturën shtetërore, duke iu dhënë më shumë përparësi formimit të përgjithshme të studentëve nga shkolla e mesme por edhe duke mos lene pas përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p>Duke parë procedurën e ndjekur në bazë të evidencave përkatëse, GVJ konstaton se institucioni në hartimin dhe zbatimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, ndjek plotësisht në mënyrë rigoroze gjithë hapat e parashikuara në aktet nënligjore në fuqi të çdo viti akademik të nxjerra nga MAS si dhe në përcaktimet dhe hapat ligjore të parashikuara në dokumentet zyrtare të USH (Statut, Rregullore).</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Vendim Senati per Kuotat</b>  <b>Statuti i USH</b>  <b>Rregullore e USH</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>Rregullore e Programit MI</b>  <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve hartohen duke u bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe parashikojnë edhe regjistrimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Në faqen web të USH publikohen dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p> <p><b>Evidenca: Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni i USH harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Referuar takimeve në institucion dhe RVB, USH aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Takime në institucion</b></p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>FSHN garanton barazinë dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në programin e studimit Bachelor në Matematikë.</i></li> <li>- <i>Ka një bashkëpunim të mirë ndërmjet hallkave të ndryshme konsultative dhe vendimarrëse në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me pranimin e studentëve.</i></li> <li>- <i>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej MAS. Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</i></li> <li>- <i>Në faqen web të USH publikohen dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</i></li> <li>- <i>USH aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtetas në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</i></li> </ul> <p><i>GVJ vlerëson se USH/FSHN/DM kanë hartuar, ndjekin dhe zbatojnë politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

<b>Standardi V.2</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri I.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Ndër mënyrat për të marrë informacion të plotë, në USH, në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Faqia zyrtare e internetit.</li> <li>➤ Sekretaria mësimore e cila ju jep informacion të detajuar studentëve për lëndët, kreditet, kalimin në vitin e dytë të studimeve.</li> <li>➤ Java e orientimit të studentët ku ata informohen për programin mësimor, ambjentet, detyrimet dhe të drejtat e studentëve.</li> </ul> <p>Burime bazë të informimit janë rregulloret e institucionit (Rregullorja e USH. Rregullorja e FSHN) si dhe Rregullorja e programit të studimit. Në to jepen elementë të tillë si pranimi në programin e studimit, pezullimi i studimeve, mobiliteti studentor, viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies, organizimi i semestrave mësimorë, organizimi i grupeve mësimore, procesi i regjistrimit për frekuentimin e kursit, frekuentimi i orëve mësimore, kontrolli i dijeve, zhvillimi i provimeve gjatë semestrit, organizimi i sezoneve të riprovimeve,</p>

	<p>rregullat e provimit, ankimi i provimeve, organizimi i kurseve intensive (për ndjekjen me frekuentim intensiv 2-3 javor të lëndëve të caktuara), përmirësimi i notës, mbrojtja e diplomës, organizimi dhe vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës etj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Statuti i USH</b>  <b>Rregullore e USH</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>Rregullore e Programit MI</b>  <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studime të mëparshme janë të pasqyruar në rregulloren e FSHN. Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme. Referuar rregullores së programit të studimit dhe nga takimet në institucion, GVJ u informua se për studentët të cilët përfitojnë mobilitete jashtë vendit, në se ata fitojnë kredite në institucionet pritëse, këto kredite mund t'ju njihen edhe në USH.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>Rregullore e Programit MI</b>  <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Javën e parë të semestrit organizohen ditë informuese me studentët e vitit të parë ku studentët njihen me një numër elementesh të cilët kanë të bëjnë me jetën studentore në USH përfshirë dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, rregullores së programit të studimit dhe rregullores së FSHN, gjatë javës së orientimit studentët informohen edhe për procedurat që duhet të ndjekin për detyrimet përmblyëse. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi. Studentët të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet e tjera akademike, duhet të paraqesin pranë Sekretarisë Mësimore të FSHN, "Kërkesën për tu regjistruar në Provimin/Temën e Diplomës" të plotësuar, sipas formatit të miratuar, të paktën 2 javë nga data e shpallur nga FSHN për zhvillimin e provimit të diplomimit dhe</p>

	<p>mbrojtjen e temave të diplomës. Drejtuesi i DM ngre Komisionin e Provimit të Diplomimit (KPD) për programin e studimit bachelor në Matematikë. KPD, nëpërmjet Sekretarisë Mësimore, informon studentët rreth organizimit të provimeve të diplomimit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>Rregullore e Programit</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Sektori i Karrierës dhe Alumnit ka hartuar një Material informues për maturantët që duan të vazhdojnë studimet në Universitetin e Shkodrës. Rrjetet sociale si dhe faqja web e USH-së luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p> <p>FSHN në mënyrë periodike organizon edhe ditë orientuese për maturantët. Këto takime organizohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ditë të hapura informimi ku maturantët mund të vizitojnë ambientet universitare të FSHN.</li> <li>➤ Takime informuese në gjimnaze për maturantët.</li> <li>➤ Takime informuese të organizuara në rang rajonal dhe kombëtar nga ana e MAS ose Drejtorive Arsimore Rajonale.</li> <li>➤ Takime informuese online me grupe maturantësh në rang gjimnazesh.</li> </ul> <p><b>Evidenca:</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>USH vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në Matematikë informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimeve, syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin të studimit.</i></li> <li>- <i>Gjatë javës së orientimit studentët informohen edhe për procedurat që duhet të ndjekin për detyrimet përmbyllëse.</i></li> <li>- <i>Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve.</i></li> <li>- <i>Pedagogët u bëjnë të njohur dhe u vënë në dispozicion studentëve syllabusin e lëndës duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit, mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</i></li> <li>- <i>FSHN në mënyrë periodike organizon edhe ditë orientuese për maturantët</i></li> <li>- <i>Rrjetet sociale si dhe faqja web e USH-së luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</i></li> </ul> <p><i>Burimet bazë të evidentuara të informimit janë rregulloret e institucionit, Rregullorja e USH. Rregullorja e FSHN, si dhe Rregullorja e programit të studimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij që në fillim, gjatë javës orientuese. Një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, data provimesh, konsultime, etj., është i aksesueshëm edhe nëpërmjet faqes së internetit të USH, sistemit të informacionit Pitagora si dhe nëpërmjet klasave virtuale të krijuara nga pedagogët (Google Classroom). Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm mbi programin e studimit si dhe kurrikulën e programit të studimit, ku pasqyrohet qartë lista e lëndëve, kreditet për çdo lëndë, shpërndarja e tyre sipas semestrave dhe tipologjia (me detyrim ose me zgjedhje).</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>Rregullore e Programit MI</b>  <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Sistemi Pitagora, faqja zyrtare e internetit dhe klasave virtuale të krijuara nga pedagogët (Google Classroom) janë disa nga format me anë të të cilave studentët informohen dhe gjejnë informacion të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Gjithashtu një informacion të plotë për lëndët studentët e marrin në javën e parë të zhvillimit të çdo moduli përkatës nga pedagogu i lëndës. Në faqen e internetit gjendet i publikuar edhe orari i programit të studimit, kurrikula si dhe kalendari akademik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan Sektori i Karrierës dhe Alumnit. Shërbimet kryesore që ofron ky sektor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ofrimi tek studentët i informacioneve dhe trajnimeve (mbi situatën në tregun e punës, përgatitjen e CV-së profesionale, letrës së motivimit, aftësitë e buta, etj.).</li> <li>➤ Integrimi i studentëve në përmirësimin e njohjes së cilësive të tyre (identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta, ndërjegjësimi për aftësitë e tyre).</li> <li>➤ Ofrimi i mundësive për zhvillimin e kompetencave të tyre (duke marrë parasysh aftësitë e menaxhimit të karrierës).</li> </ul>

	<p>➤ Njohjen me mundësitë e punësimit (oferta për punësim, praktika, vullnetarizëm).</p> <p>Udhëzuesi i karrierës i përgatitur për këtë qëllim përbën një kontribut me vlerë për orientimin e studentëve. Gjatë takimit me studentë të programit të studimit GVJ u informua se shërbimi i karrierës u dërgon email-e për mundësi punësimi si dhe organizon takime informuese për tregun e punës.</p> <p>Studentët që kanë dëshirë të punësohen në fushën e informatikës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve janë në kontakt të me përfaqësuesit e biznesit. Këta të fundit zhvillojnë në mënyrë periodike trajnime ose testime për identifikimin e studentëve potencial për punësim si dhe informojnë vazhdimisht studentët për kërkesat e tregut të punës dhe për mundësitë e punësimit të tyre në përfundim të programit të studimit dhe në disa raste edhe gjatë kohëzgjatjes së programit të studimit</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>RVB e programit</b> <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë javës së parë të orientimit të viteve të para studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Informacioni për ambientet ku do zhvillohet mësimi janë gjatë gjithë kohës të aksesueshme nga studentët në sistemin Pitagora. Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve për regjistrimet, pagesat, notat etj.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>RVB e programit</b> <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit etj nëpërmjet faqes web të institucionit dhe nëpërmjet sistemit Pitagora, i cili është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. Gjithashtu, një pjesë e mirë e informacionit shpërndalet dhe mund të aksesohet nëpërmjet platformës Google for Education (Google Drive, Google Classroom).</p> <p><b>Evidenca: Takime në institucion</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Studentët e programit të studimit Bachelot në Matematikë informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</i></li> <li>- <i>FSHN shpërndan informacion edhe nëpërmjet faqes zyrtare web duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë.</i></li> <li>- <i>Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve.</i></li> </ul>



	<p>- Një rol të rëndësishëm në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan dhe Sektori i Karrierës dhe Alumnit.</p> <p>Sistemi i informacionit Pitagora, ofron informacion në lidhje me programin e studimit Bachelor në Matematikë dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Mbajtja e statistikave për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit kryhet nga sekretaria mësimore e FSHN. Të dhënat përpunohen nga sekretaria mësimore dhe ruhen si në format fizik, regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave ashtu dhe në format elektronik. Gjithashtu të dhënat dhe statistikat mund të përpunohen edhe nga sistemi Pitagora.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Programi i studimit</th> <th>Viti Akademik</th> <th>Numri total i të diplomuarve</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Bachelor në Matematikë</td> <td>2020-2023</td> <td>60</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistrat themeltar dhe regjistrat të lëshimit të diplomave janë në përputhje me standardet dhe udhëzimet e MAS.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Tabelat permbljedhese (Tabela 23.1)</b>  <b>Takime në institucion</b></p>	Programi i studimit	Viti Akademik	Numri total i të diplomuarve	Bachelor në Matematikë	2020-2023	60				
Programi i studimit	Viti Akademik	Numri total i të diplomuarve									
Bachelor në Matematikë	2020-2023	60									
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Të dhënat në lidhje me studentët mbahen në formë elektronike në sistemin Pitagora dhe në format letër. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbledhjen e informacionit dhe administrimin e dokumentacionit për çdo student që në momentin e regjistrimit të tij deri në përfundim të studimeve. Kjo strukturë administron të dhëna në lidhje me procedurat e transferimit dhe ç' regjistrimet që mund të ketë gjatë vitit akademik. Të dhënat pasqyrohen në regjistrin themeltar të studentëve, regjisitri i gjeneraliteteve dhe notave, dhe regjistrat e lëndëve semestrale. Regjistrimet, për tre vitet e fundit paraqiten si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Programi i studimit</th> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i studentëve të regjistruar</th> <th>Studentë të transferuar sipas viteve</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Programi i studimit	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali					
Programi i studimit	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali							

		për herë të parë		
Bachelor në Matematikë	2020-2021	9	0	9
	2021-2022	5	0	5
	2022-2023	9	0	9

Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit dhe e gjeti atë në përputhje me standartet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

**Evidenca:**  
**RVB e programit**  
**Tabelat permbledhese (Tabela 21.1)**  
**Takime në institucion**

**Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

FSHN/USH përdor sistemin elektronik Pitagora, ku pedagogët, sekretaret dhe studentët kanë profilet e tyre sipas autorizimeve përkatëse. Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen në format letër, në regjistrat përkatës, si dhe në sistemin Pitagora, ku stafi akademik hedh të dhënat dhe ndjek ecurinë e studentëve përgjatë vitit akademik, po ashtu edhe vetë studentët mund të ndjekin ecurinë e tyre përmes sistemit.

**Evidenca: Takime në institucion**

**Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.

Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.). Veprimtaria e Sekretarisë mësimore të FSHN mbështetet në rregulloren e USH dhe rregulloren e FSHN. Rregullorja e FSHN përcakton se Sekretaria mësimore e FSHN-së është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel fakulteti dhe ka për mision funksionimin, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik. Në kete rregullore përcaktohen qartë detyrat e Kryesekretarisë dhe Sekretarisë mësimore. Kryesekretaria ka varësi të drejtpërdrejtë nga Dekani i FTI, i cili menaxhon procesin e kontrollit periodik të përvitshëm dhe vlerësimit e dokumentimit të gjendjes dhe saktësisë së informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.

**Evidenca:**  
**Rregullore e USH**  
**Rregullore e FSHN**  
**Takime në institucion**

**Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e

DM/FSHN/USH hartojnë raporte analitike vjetore. Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Sektori i Karrierës dhe Alumnit analizon gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti ashtu dhe instanca të tjera. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat

duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	përpunohen në nivel insitucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik. <b>Evidenca:</b> <b>Tabela permbledhese Bachelor Matematike (Mungojne Tabela 21.1&amp; Tabela 24.1)</b> <b>Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</b> <b>Analize vjetore</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> - Sekretaria mësimore e FSHN mban statistika për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen dhe ruhen si në format fizik, rregjistrat themeltar, rregjistrat e lëshimit të diplomave, ashtu dhe në format elektronik nëpërmjet sistemit Pitagora. - Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. - Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Sektori i Karrierës, dhe Alumnit analizojnë gjendjen e punësimit të studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstatoi se USH ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve të USH-së, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të USH-së në të gjitha programet e studimit. Këshilli studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studjuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilanci vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Në anëtarët e Senatit Akademik përfshihen dhe dy përfaqësues të studentëve, duke mundësuar në këtë mënyrë transmetimin e zërit të tyre në këtë organ drejtues si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. <b>Evidenca:</b> <b>Statuti i USH</b> <b>Takime në institucion</b>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>USH/FSHN kanë garantuar përfshirjen e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse, këshillat, etj. Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. Sipas rregulloreve të USH dhe FSHN studentët shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë. Nga takiment në institucion me studentët, këto pyetësorë realizohen përpara provimeve dhe janë anonime duke shprehur mendimin real të tyre.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Statuti i Universitetit</b>  <b>Rregullore e Universitetit</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>Manuali i cilësisë USH</b>  <b>Keshillat studentore</b>  <b>Analiza e pyetësorëve</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sUSHerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të USH bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët tërhiqet, ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Përpunimi i të dhënave të këtij pyetësori për çdo program studimi, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Megjithatë, referuar dokumentacionit të paraqitur, nuk ka patur përmirësime në kurrikulën e programit të studimit në tre vitet e fundit. GVJ gjatë takimeve në institucion u informua se elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Statuti i Universitetit</b>  <b>Rregullore e Universitetit</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>Manuali i cilësisë USH</b>  <b>Analiza e pyetësorëve</b>  <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në rregulloret e USH dhe FSHN janë të përcaktuar qartë mënyra e vlerësimit të studentëve për vlerësimin përfundimtar duke ju mundësuar dhënien e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në FSHN/USH vlerësimi përfundimtar i çdo kursi kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit. Në rregulloren e FSHN përcaktohet se studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Dekanit të FSHN jo më vonë se 3 ditë kalendrike nga dita e publikimit të rezultateve dhe trajtimi i ankesës kryhet sipas një procedure të mirëpërcaktuar në rregullore e cila shkon deri në një shikim eventual të tezës së provimit nëpërmjet një komisioni ad-hoc.</p> <p><b>Evidenca:</b></p>

	<b>Rregullore e Universitetit</b> <b>Rregullore e FSHN</b>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>USH garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</i></li> <li>- <i>Studentët në USH janë të organizuar në Këshilla Studentore duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit.</i></li> <li>- <i>Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të USH si dhe përpunimi i pyetsorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit</i></li> <li>- <i>Elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve.</i></li> <li>- <i>Vlerësimi i kontrollit të dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave e përcaktuara në rregulloret përkatëse të cilat garantojnë barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit. Studentëve u njihet e drejta e ankimimit..</i></li> </ul> <p><i>GVJ vlerëson se USH/FSHN/DM përfshijnë dhe angazhojnë studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Gjithashtu studentët përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përbashkë e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Në USH funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Sektor i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës</li> <li>➤ Sekretaria Mësimore</li> </ul> <p>Sektor i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës ofron këshillime, orientim karriere dhe seminare për t'i ndihmuar studentët të qartësojnë qëllimet akademike dhe të karrierës, të krijojnë plane të karrierës, të zhvillojnë aftësitë e krijimit të punës dhe të bëjnë një kalim të suksesshëm nga universiteti në tregun e punës.</p> <p>Sekretaria mësimore e FSHN-së është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel fakulteti dhe ka për mision funksionimin, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik.</p>

	<p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Takime me studentët Këshillimi i Karrierës</b>  <b>Takime në Institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Përveç Sekretarisë Mësimore e cila disponon dhe vë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me regjistrimin dhe avancimin akademik të studentëve, për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të tyre dhe asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, një rol të veçantë luan dhe pedagogu mentor. Qëllimi kryesor i mentorimit është asistimi, këshillimi, mbështetja e studentëve në lidhje me problemet që mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së studimeve në FSHN si dhe përpjekja për të maksimizuar rritjen dhe zhvillimin e studentëve në fushën akademike, atë profesionale e më gjerë. Mentorimi është një proces edukues në të cilin pedagogu mentor shërben si mësues, inkurajues dhe këshillues me qëllimin përfundimtar të promovimit të zhvillimit profesional dhe personal të tyre. Pedagogu mentor monitoron zhvillimin e studentëve dhe ndërhyr për të ndihmuar përparimin e tyre. Ai asiston studentët gjatë formimit të tyre akademik dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në jetën social-kulturore dhe në klube studentore dhe aktivitete të organizuara nga FSHN. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në varësi të Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike zhvillon gjithashtu komunikimin efektiv dhe etik me studentët.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Takime me studentët Këshillimi i Karrierës</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit/Rrjetin Alumni, dhe krijon mundësi punësimi për studentët/ alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e. Programi i studimit Bachelor në Matematikë nuk ka të parashikuar praktikë profesionale si element të veçantë në programin mësimor, nga ku studentët të mund të kishin një qasje jo vetëm për praktikë, por edhe për zhvillim karriere.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Takime me studentët Këshillimi i Karrierës</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mban të dhëna për punësimet pas diplomimit. Gjithashtu ky sektor është struktura përgjegjëse që harton dhe raporton periodikisht në MASR të dhëna statistikore. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mundëson:</p>

<p>në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Informimin e studentëve për mundësitë e punësimit (nëpërmjet postës elektronike si dhe nëpërmjet zhvillimit të takimeve informuese)</li> <li>➤ Zhvillimin e trajnimeve</li> <li>➤ Mbajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar</li> <li>➤ Krijimin dhe përditësimin e të dhënave për punësimin e studentëve</li> <li>➤ Asistimin e studentëve për programe bursash jashtë vendit.</li> <li>➤ Hartimin e raporteve dhe statistikave dhe vënien në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</li> </ul> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e FSHN</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Takime me studentët Këshillimi i Karrierës</b></p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në USH funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, Sekretaria Mësimore njësi të cilat janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</li> <li>- Pedagogu mentor asiston studentët gjatë formimit të tyre akademik dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në jetën social-kulturorë dhe në klube studentore dhe aktivitete të organizuara nga FSHN.</li> <li>- Programi i studimit Bachelor në Matematikë nuk ka të parashikuar praktikë profesionale si element të veçantë në programin mësimor, nga ku studentët të mund të kishin një qasje jo vetëm për praktikë, por edhe për zhvillim karriere.</li> </ul>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>FSHN e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standardet e vendosura nga USH dhe ato shtetërore të cilësisë, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). Gjithashtu, për të rritur kapacitetet didaktike të stafit akademik, USH përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p><b>Evidenca: Strategjia e mesimdhënies</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>DM është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Bachelor në Matematikë dhe përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo detyrë drejtohet nga Përgjegjësi i DM. Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik drejtohet nga NjSBC. GVJ u informua se vlerësimi i lektorëve nga studentët realizohet 2 herë në vit. Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit dhe Dekanati. Ndërsa në fund të vitit raportohet sërish analiza mësimore e cila integrohet në analizën mësimore kërkimore të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Raport vjetor DM</b>  <b>Manuali i cilësisë USH</b>  <b>Takime në Institucion.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në Matematikë. Ky pyetësor plotësohet në fund të çdo semestri. Pyetësori është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. Garantimi i ankimit të rezultatit të provimit bazohet në procedurën e përcaktuar në rregullore.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Këshillat studentorë</b>  <b>Analiza e pyetësorëve</b>  <b>Manuali i cilësisë USH</b>  <b>Rregullore e FSHN</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e</p>	<p>Çdo anëtar i personelit akademik informohet me anë të postës elektronike në lidhje me rezultatet e tij për këtë anketim. Rezultatet e anketimit i dërgohen të grupuara sipas njësive përkatëse edhe drejtuesve</p>



<p>cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>të njëjësive bazë dhe njëjësive kryesore. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelin akademik, përgjegjësit e njëjësive bazë analizojnë rezultatet e ankimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuar për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Publikimi i raporteve të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies kryhet nga ana e NJSBC, duke i vënë kështu rezultatet e vlerësimit në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Këshillat studentorë</b>  <b>Analiza e pyetësorëve</b>  <b>RVB e programit</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>NJSBC luan një rol të rëndësishëm në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. Ajo njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare. Rezultatet e përpunuara publikohen dhe në faqen web të USH.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Analiza e pyetësorëve</b>  <b>RVB e programit</b>  <b>Takime në Institucion</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>FSHN e zhvillon programin e studimit Bachelor në Matematikë në përputhje me standardet e vendosura nga USH dhe ato shtetërore të cilësisë.</i></li> <li>- <i>Stafi akademik i USH përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, për të rritur kapacitetet didaktike.</i></li> <li>- <i>NJSBC drejton në nivel institucioni punën për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</i></li> <li>- <i>Pyetësorët e vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në Matematikë mundësojnë garantimin e përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve.</i></li> </ul> <p><i>NJSBC publikon raporte të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Standardi VI.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse, në nivel institucional, për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në USH janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Senati Akademik.</li> <li>➤ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</li> <li>➤ Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.</li> </ul> <p>Përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në nivel Fakulteti janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve.</li> <li>➤ Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program.</li> <li>➤ Koordinatorët e Programeve.</li> </ul> <p>Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të cilësisë në nivel institucional jepen në Statut ndërsa detyrat e strukturave në nivel fakulteti janë përcaktuar në Rregulloren për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. GVJ konstaten se këto struktura janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Manuali i cilësisë USH</b>  <b>Statuti i Universitetit</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NJSBC e FSHN kryen funksionet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti. Kjo njësi monitoron dhe vlerëson proceset e sigurimit të cilësisë bazuar në manualët dhe treguesit e hartuar nga NJSBC institucionale. NJSBC monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikëqyr proceset e vlerësimit të brendshëm dhe raportimin në rastet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë etj. Investimi në cilësinë e mësimdhënies përbën një përparësi të USH Synohet që në vitet 2020-2025, USH do të ketë një model të përmirësuar të garantimit të cilësisë së mësimdhënies, ku modeli aktual do të plotësohet dhe kombinohet me metodologji më të kompletuara si: peer to peer, fokus group, sondazhe të shpeshta, etj. Investimet në USH do të kryhen me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Manuali i cilësisë USH</b>  <b>Strategjia e zhvillimit të USH</b>  <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Akreditimi i jashtëm kryhet periodikisht në USH. Institucionit i është dhënë një vlerësim pozitiv për cilësinë akademike me një kohëzgjatje prej 4 vitesh, me Vendimin nr. 18 datë 24.03.202, të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në Matematikë, me qëllim akreditimin e tij, po realizohet për herë të parë nga ASCAL.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>RVJ Institucional</b>  <b>VKM për hapjen e programit të studimit Bachelor në Matematikë_USH</b></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Në mënyrë periodike, NJSBC zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Vlerësimin të stafit akademik nga studentët.</li> <li>➤ Vlerësimin të lëndës.</li> <li>➤ Vlerësimin të kënaqësisë së studentëve nga institucioni.</li> <li>➤ Pyetësori Alumni.</li> <li>➤ Pyetësorë me stafin akademik dhe atë administrativ mbi vlerësimin e kënaqësisë së tyre ndaj Institucionit.</li> </ul> <p>NJSBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë mes gjithë aktorëve të brendshëm të tij.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Këshillat studentorë</b>  <b>Analiza e pyetësorëve</b>  <b>Manuali i cilësisë USH</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në USH, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, garantohet nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</li> <li>- NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe në nivel njësie kryesore, në USH.</li> <li>- NJSBC monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikëqyr proceset e vlerësimin të brendshëm, raportimin në rastet e vlerësimin të jashtëm të cilësisë etj.</li> <li>- Në mënyrë periodike, NJSBC zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin.</li> </ul> <p><i>NJSBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe</p>	<p>Mbikëqyrja e periodike e programit të studimit Bachelor në Matematikë bazohet në marrjen e informacionit nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen në fund të çdo semestri. Pyetësorët i kushtohen vlerësimin të lëndëve të programit të studimit dhe personelit akademik. DM shqyrton veprimtarinë mësimore duke kryer analiza vjetore të realizimit të procesit mësimor, punës administrative dhe asaj kërkimore shkencore në të cilat shqyrtohen problematikat e hasura dhe hapat konkrete në</p>

<p>dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>drejtim të përmirësimit. Të gjitha udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore ndiqen dhe zbatohen.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Raport vjetor DM</b>  <b>Takime në institucion.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vetëvlerësimit hartohen në nivel institucioni. Në to jepet një tablo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik. Për personelin akademik janë aplikuar “Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësive të USH”. Këto kritere janë të miratuar në të gjitha nivelet dhe përfaqësojnë një listë treguesish të veprimtarisë kërkimore-shkencore të vendosur në një sistem pikëzimi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Raport vjetor DM</b>  <b>Manuali i cilësisë USH</b>  <b>Rregullore e NJSBC</b>  <b>Takime në institucion.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në USH përdoren mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit. Monitorimi i realizimit me korrektësi të programit Bachelor në Matematikë realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga koordinatori i programit, drejtuesi i njësisë bazë si dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në rang institucioni dhe njësie kryesore.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Manuali i cilësisë USH</b>  <b>Rregullore e NJSBC</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e</p>	<p>Studentët në USH janë pjesëmarrës aktivë në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Matematikë. Mendimi i tyre merret nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Këshillit Studentor.</li> <li>➤ përfshirjes në procesin e vlerësimit të programeve të studimeve (pjesë e GVB).</li> <li>➤ këshillimit me stafin akademik dhe përgjegjësen e departamentit si edhe përdorimit të zyrave mbështetëse për këtë qëllim.</li> <li>➤ Përfaqësuesit të studentëve në NJSBC.</li> <li>➤ Pjesëmarrjes në Senatën Akademik.</li> </ul>

<p>programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Pjesëmarrjes në Këshillin e Etikës.</li> <li>➤ Pjesëmarrjes në Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së institucionit.</li> </ul> <p>Në procesin e vlerësimit kontribuojnë zhvillimi i anketimeve nëpërmjet pyetësoreve të studentëve, mbledhjes së të dhënave nga sekretaria mësimore në lidhje me rezultatet e provimeve, kalueshmërinë, notën mesatare etj, gjurmimit të studentëve të diplomuar, etj. Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të tërthorta të vlerësimit në institucion.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Takime në institucion.</b>  <b>Statuti i Universitetit</b>  <b>Rregullore e NJSBC</b>  <b>Strategjia e zhvillimit të USH</b></p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në USH ndiqen dhe zbatohen të gjithë udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore për mbikëqyrjen periodike të programit të studimit Bachelor në Matematikë.</li> <li>- Raportet e vetëvlerësimit, në të cilët jepet një tablo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik hartohen në nivel institucioni.</li> <li>- Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta të vlerësimit në institucion.</li> </ul>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="632 978 804 1043">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="810 978 1031 1043">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1037 978 1246 1043">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1252 978 1422 1043">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në USH, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBC, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Matematikë, në planin strategjik të institucionit synohet dhe ndërkombëtarizimi i programeve të studimit dhe shqyrtimi i mundësive për krijimin dhe realizimin e programeve të përbashkëta dhe të dyfishta studimi me universitete të huaja, sidomos të programeve që zhvillohen në gjuhën angleze. Objektivi i institucionit është edhe rritja e numrit të profesorëve dhe studiuesve të huaj nga universitetet prestigjioze ndërkombëtare. Këto objektiva strategjike do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Matematikë dhe në një përshtatje më të mirë e të vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e NJSBC</b></p>


	<b>Strategjia e zhvillimit të USH</b>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullorja "Për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë" përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Rregullorja synon, përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përbushur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë USH, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Edhe plani strategjik i USH ka në fokusin e tij promovimin e një kulture të vëmendjes ndaj cilësisë nëpërmjet procedurave efektive të menaxhimit dhe organizimit të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e NJSBC</b>  <b>Strategjia e zhvillimit të USH</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Një proces gjithëpërfshirës në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Matematikë garanton ato. Nga takimet në institucion, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. Në përmirësimin e cilësisë së programit një rol të rëndësishëm luajnë dhe pyetësorët e studentëve si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme konsultative e vendimmarrëse.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e NJSBC</b>  <b>Manuali i cilësisë USH</b>  <b>Keshillat studentore</b>  <b>Analiza e pyetësorëve</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në veprimtarinë e saj me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë, NJSBC mbështetet edhe nga institucioni, FSHN dhe DM. Në punën e saj NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Rregullore e NJSBC</b>  <b>Takime në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Matematikë zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë arsimore dhe bizneset. Në aspektin e aktivizimit të aktorëve të jashtëm si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, kryhet edhe "Panairi i Punës dhe Karrierës" i organizuar nga USH ku marrin pjesë subjekte publike dhe private. Gjithashtu në procesin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit kanë ndihmuar mobilitetet Erasmus+ dhe organizimi i leksioneve të hapura me të ftuar nga jashtë institucionit.</p>

cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<b>Evidenca:</b> <b>Manuali i cilësisë USH</b> <b>Shembull transferimesh te studenteve ne ERASMUS</b> <b>Takime në institucion</b>											
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstatos se:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në USH, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBC, e cila synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</li> <li>- Plani strategjik i USH ka në fokusin e tij promovimin e një kulture të vëmendjes ndaj cilësisë nëpërmjet procedurave efektive të menaxhimit dhe organizimit të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale.</li> <li>- Ka një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit.</li> <li>- NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie.</li> </ul> <p>Në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit Bachelor në Matematikë kanë kontribuar dhe Panairi i Punës dhe Karrierës, mobilitetet Erasmus+ e leksione të hapura.</p>											
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <td style="width: 25%;">Nuk përmbushet</td> <td style="width: 25%;">Përmbushet pjesërisht</td> <td style="width: 25%;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="width: 25%;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X			
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht									
			X									


**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Publikimi i rezultateve të veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në Matematikë siguron transparencën e këtyre veprimtarive. Rezultatet e tyre publikohen në trajtën e raporteve dhe vlerësimeve që kanë të bëjnë me institucionin dhe studentët. Në faqen zyrtare web të USH bëhen publike rezultate të pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Rektoratit, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj. <b>Evidenca: Manuali i cilësisë USH</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	Stafit akademik i Programit Bachelor në Matematikë vihet në dijeni individualisht për pyetësorin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. DM informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. GVJ konstaton se informacioni me rezultatet e vlerësimeve të publikuara në faqen web të institucionit respektojnë lirinë akademike si edhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me

legjislacionin për të dhënat personale.	ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit. <b>Evidenca: Takime në Institucion</b>
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Pasi procesi i anketimeve me studentët evidenton mangësi dhe dobësi ai shoqërohet me plan masash konkrete për përmirësimin e tyre. Identifikimi i zgjidhjeve dhe zbatimi i tyre realizohet nga drejtuesit e FSHN. Nëse ka nevojë për mbështetje fiannciare bashkëpunohet me bizneset. <b>Evidenca:</b> <b>Takime në institucion.</b> <b>RVB e programit</b>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga ana e USH-se, GVJ konstaton përpjekje në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit Bachelor në Matematikë. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që USH i jep këtij procesi. <b>Evidenca:</b> <b>Takime në institucion.</b>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Hartimi i RVB për programin e studimit Bachelor në Matematikë dhe grumbullimi i informacionit në mbështetje të tij ka qenë një proces në të cilin është angazhuar jo vetëm GVB, por edhe gjithë instancat drejtuese të USH dhe FSHN, DM si dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Ky proces kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të programit të studimit për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së tij. Procesi i realizimit të pyetësorëve kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Ndikim pozitiv, në këtë drejtim, ka dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative (Senat, Këshillin e Etikës, Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së institucionit) në të cilat diskutohen problematika që kanë lidhje me përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Për të rritur kapacitetet didaktike të stafit akademik, USH përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. <b>Evidenca:</b> <b>Takime në institucion.</b> <b>RVB e programit</b> <b>Manuali i cilësisë USH</b>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Publikimi i rezultateve të veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në Matematikë siguron transparencën e këtyre veprimtarive. Transparenca e tyre sigurohet nëpërmjet publikimit të rezultateve në trajtën e raporteve dhe vlerësimeve si dhe nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit të rezultateve të përmbledhura të pyetësorëve, Statutit, Rregullores, Vendimeve të Senatit Akademik, Vendimeve të Rektoratit, Vendimeve të Bordit të Administrimit, etj.</i>






	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Stafit akademik i programit vihet në dijeni individualisht për pyetëtorin në lidhje me performancën e tij ndërsa DM informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. Informacioni me rezultatet e vlerësimeve respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</li> <li>- Grumbullimi i informacionit në mbështetje të hartimit të RVB, anketimet me studentët dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative mundësojnë evidentimin e pikave të forta, problematikave, kërcënimeve dhe kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të programit të studimit për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së tij.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Matematikë” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Përgatitja didaktike e stafit akademik është shumë e mirë.
2. Ambientet fizike, materialet didaktike, labororet janë një aset i këtij departamenti.
3. Nga biseda me studentët u vu re se komunikimi dhe bashkëpunimi student – pedagog është për tu përgëzuar.

**Pika të dobta:**

1. Mungon një vlerësim i mirëfilltë i shprehur me vlera sasiore për tregun e punës dhe strategjinë e punësimit për studentët të cilët diplomohen në Bachelor “Matematikë”. **(Standardi II.4)**
2. Studentet nuk janë të përfshirë në projekte kërkimore. **(Standardi I.2)**
3. Numri i vogël i orëve të labororeve. **(Standardi II.4, kriteri 6)**

**Rekomandime:**

1. Rekomandohet hartimi dhe zbatimi i një plani masash të menjëhershme me qëllim promovimin e programit të studimit Bachelor Matematikë.  
Departamenti i Matematikës në veçanti duhet të realizojë një studim të tregut të punës, e cila mund të përbëjë një bazë për përcaktimin e kuotave të pranimit për këtë program studimi.
2. GVJ evidenton se në disiplinat matematikore zhvillohen vetëm leksione dhe seminare dhe sugjeron që të shtohen edhe orë laboratorike, sidomos në lëndët Probabilitet-Statistikë të cilat mundësohen nëpërmjet softveve kompjuterike.
3. Studentët e ciklit të parë në Matematikë kanë qenë të përfshirë në programin “Erasmus +”, por nuk vihet re trend për ardhje studentësh me anë të transferimit të studimeve apo për punësim pas përfundimit të studimeve.
4. Sugjerohet që në pyetësorët e hartuar të marrin gjykimin e studentit në lidhje me rezultatet e kontrollit si dhe një analizë sasiore në lidhje me këtë çështje.
5. Rekomandohet përfshirja e lëndëve me karakter ekonomik, me qëllim që studentëve t’u jepet mundësi e diversifikimit të studimeve në ciklin e dytë, për faktin që USH ka në përbërje edhe Fakultetin e Ekonomisë me disa programe në ciklin e dytë.
6. GVJ sugjeron, se në kuadrin e ndërkombëtarizimit dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies faja zyrtare e internetit të USH duhet të mundësohet edhe në gjuhën angleze.
7. GVJ shpreh mendimin se departamenti duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar grante të huaja në formën e projekteve të cilat mundësojnë pasurimin e labororeve didaktikë dhe kërkimore, pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë të huaj dhe vënien e tyre në funksion të plotë të realizimit dhe përmisimit të programit të studimit.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Mathematics" provided by the Higher Education Institution University of Shkodra "Luigj Gurakuqi"**

**Strengths and affirmations**

1. The didactic preparation of the academic staff is very good.
2. Physical facilities, didactic materials, laboratories are an asset of this department.
3. From the conversation with the students, it was noticed that the communication and cooperation between student and lecturer is to be congratulated.

**Weaknesses**

1. There is a lack of a genuine evaluation expressed with quantitative values for the labor market and the employment strategy for students who graduate in Bachelor of Mathematics.
2. Students are not involved in research projects.
3. Small number of laboratory hours.

**Recommendation**

1. It is recommended to draw up and implement an immediate action plan to promote the Bachelor of Mathematics study program. The Department of Mathematics in particular should carry out a study of the labor market, which can form a basis for determining the admission quotas for this study program.
2. The external experts notes that only lectures and seminars are held in mathematical disciplines and suggests that laboratory hours be added, especially in Probability-Statistics subjects which are made possible through computer software.
3. The students of the first cycle in Mathematics have been included in the "Erasmus +" program, but no trend is observed for the arrival of students through the transfer of studies or for employment after the completion of studies.
4. It is suggested that in the designed questionnaires there are questions that take the student's judgment regarding the control results as well as a quantitative analysis regarding this issue.
5. It is recommended to include subjects with an economic character, in order to give students the opportunity to diversify their studies in the second cycle, due to the fact that USH also has the Faculty of Economics with several programs in the second cycle.
6. The external experts suggests that in the framework of internationalization and increasing the quality of teaching and learning, the official website of USH should be made available in English as well.
7. The external experts expresses the opinion that the department should make continuous efforts to secure foreign grants in the form of projects that enable the enrichment of didactic and research laboratories, the enrichment of the library fund with foreign literature and their full operation of the realization and improvement of the study program.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X